

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5936
E enjte, 21 nëntor 2019
çmimi 0.40 €

Ku do të ndërtohet stadiumi kombëtar, në Drenas apo Prishtinë?

FAQE 20



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", VALDETE DAKA

FAQE 4-5



KQZ-ja PADREJTËSISHT PO AKUZOHET PËR ZVARRITJE TË PROCESIT ZGJEDHOR

Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Valdete Daka, i ka vlerësuar të padrejta akuzat ndaj këtij institucioni për zvarritje të procesit të zgjedhjeve të 6 tetorit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka deklaruar se KQZ-ja nuk po e zvarrit

këtë proces, por është duke zbatuar vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) për rinumërim, i cili është i obligueshëm. Sipas Dakës, vetë subjektet politike kanë kërkuar nga PZAP-i rinumërimin e kutive të votimit. Ajo ka pohuar se

zgjedhjet e 6 tetorit kanë qenë mirë të organizuara. "Të gjitha çështjet që kanë ndodhur pas ditës së zgjedhjeve padrejtësisht i vihen si barrë KQZ-së, duke harruar se ato çështje janë ngritur nga subjektet politike dhe pastaj janë bërë temë e ankesave", ka thënë Daka

OPINION

BOTA RRETH NESH PO NDRYSHON, PO NE A PO E KUPTOJMË? F. 8

Shkruan:
Valon
MURATI



AKTUALE



NË OKUK KËTË VIT U REALIZUAN 3 500 PROCEDURA INVAZIVE F. 3

MINISTRI TAHIRI: ËSHTË KOHA TË LËVIZIM DREJT ANËTARËSIMIT NË KONVENTAT E HAGËS F. 7

EKONOMI

NGA 2 462 NDËRMARRJE TË REGJISTRUARA, 96 PËR QIND E TYRE JANË BIZNESE TË VOGLA F. 7

KMDLNJ FTON QYTETARËT TË PROTESTOJNË KUNDËR SHITJES TË SIGURIMIT TË VETURAVE F. 9

KULTURË

LIBËR I DHEMBJES DHE I KRENARISË F. 16

Prof. dr. Sabile
KEÇMEZI-BASHA



Nga skema e ndihmës sociale përfituan 24 526 familje

FAQE 9



Sot një vit nga vendosja e taksës 100 për qind ndaj mallrave nga Serbia dhe Bosnja

Më 6 nëntor të vitit të kaluar Qeveria në largim e Kosovës vendosi taksën prej 10 përqindësh për prodhimet me origjinë nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina, kurse më 21 nëntor kjo taksë u rrit në 100 për qind për të gjitha produktet dhe mallrat e importuara nga këto dy shtete. Me rastin e njëvjetorit të vendosjes së taksës, këtë vendim vazhdon ta mbrojë kryeministri në largim, Ramush Haradinaj. Ai ka thënë se një vit më parë Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndërmarrë një prej vendimeve më të guximshme që nga



shpallja e pavarësisë, me vendosjen e tarifës prej 100-përqindësh në mallrat e Serbisë si masë ndaj fushatës agresive të shtetit serb

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Rasmussen: Shtyrja e negociatave efekte serioze për stabilitetin në Ballkan

Ish-shefi i NATO-s, Rasmussen ka thënë se për herë të parë në historinë e BE-së, liderët në mënyrë të dukshme kanë dështuar të mbajnë premtimet e tyre dhe se refuzimi i hapjes së negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut mund të ketë efekte serioze për stabilitetin në Ballkan



PRISHTINË, 20 NËNTOR - Vendimi i BE-së për t'i shtyrë negociatat e pranimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut mund të ketë efekte serioze për stabilitetin në Ballkan, thotë ish-sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen për gazetën daneze "Morgenavisen Jyllands-posten".

"BE-ja është duke bërë gabimin më të madh strategjik. Një muaj më parë Franca, Holanda dhe Danimarka bllokuan fillimin e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut për në BE. Po flitet për një shkelle të premtimit nga ana e BE-së. Refuzimi tashmë ka krijuar një mërzi dhe një zhgënjim të thellë, jo vetëm në Shqipëri dhe Maqedoninë Veriore, por në të gjithë Ballkanin dhe te të gjithë fqinjët e BE-së", ka thënë Rasmussen, raporton atsh.

"Kjo është më se e kuptueshme. Për herë të parë në historinë e BE-së, liderët në mënyrë të dukshme kanë dështuar të mbajnë premtimet e tyre. Refuzimi i hapjes së negociatave me të dy vendet mund të ketë efekte serioze për

stabilitetin në Ballkan. Dhe të gjithë fqinjët e BE-së kanë ngritur dyshime nëse mund të mbështeten në BE si një partner strategjik dhe aleat.

Polemika ka të bëjë për më pak se pesë milionë persona. Për disa vite, këto dy vende që kanë punuar me zell për të përbushur kushtet për fillimin e negociatave të pranimit në BE. Sipas Komisionit Evropian të dy vendet si Shqipëria ashtu edhe Maqedonia e Veriut i kanë plotësuar kushtet për fillimin e negociatave të pranimit në BE. Megjithatë, tre vende të BE-së i thanë 'jo' hapjes së negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Duke marrë në konsideratë këto negociata do të duhen edhe shumë vite përpara se këto dy vende t'i afrohen anëtarësimit në BE", ka thënë Rasmussen.

Ai ka thënë se edhe politikanët që janë skeptikë për të parë Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut si anëtare të ardhshme të BE-së, duhet të kenë interes për fillimin e procesit.

"Ne e dimë nga përvoja se këto negociata në vetvete janë një

nxitës i fuqishëm i reformës. Vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore ku sundonte diktatura komuniste janë shndërruar në demokraci, duke futur ekonominë e tregut të lirë dhe mësuar se si të zgjidhnin konfliktet e ndërsjella.

Do të duhen shumë vite përpara se ato të plotësojnë kushtet për t'u bërë anëtare të BE-së. Por është e rëndësishme që ata të mos humbasin shpresën. Maqedonia e Veriut aplikoi për anëtarësim në 2005, ndërsa Shqipëri në 2009", ka thënë ai.

"Sigurisht, ka probleme si në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut, duke përfshirë krimin e organizuar dhe menaxhim më efikas të kufijve të jashtëm. Por këto probleme mund të zgjidhen në mënyrë më efektive duke negociuar me të dy vendet dhe duke u siguruar që ato të plotësojnë kërkesat e BE-së.

Në të dy vendet janë zbatuar reforma për të përbushur kërkesat e BE-së. BE-ja kishte premtuar se do të fillonte negociatat në vitin 2020. Ka rrezik që këto reforma të ngadalësohen ose të ndalojnë plotësisht nëse BE-ja nuk i përbahet premtimeve", ka thënë ai. Rasmussen ka thënë se prej disa vitesh të dy vendet kanë punuar me vendosmëri për t'i përbushur kushtet për të filluar negociatat për anëtarësimin në BE.

"Pas shumë vitesh, Maqedonia e Veriut arriti të zgjidhte mosmarrëveshjet për çështjen e emrit të vendit me Greqinë. Tani, NATO-ja do ta pranojë Maqedoninë e Veriut si anëtare në 30-të. Shqipëria u bë pjesë e NATO-s në 2009. NATO-ja e ka kuptuar që stabiliteti i Evropës varet shumë nga qëndrueshmëria dhe siguria e Ballkanit. Refuzimi i hapjes së negociatave për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, minon bes-

imin e unionit. BE-ja, në të vërtetë, është përpjekja e NATO-s për të krijuar më shumë siguri në Evropë; ka thënë ai.

Rasmussen ka shtuar se Kina dhe Rusia janë të gatshme të mbushin boshllëkun që është bërë i disponueshëm për shkak të paaftësisë së BE-së. "Kina ka para për investime strategjike dhe Rusia qëndron e gatshme me oferta të bashkëpunimit ushtarak. Rusia tashmë është aktive në fushatën e dezinformimit për krijimin e përçarjeve dhe mosmarrëveshjeve në Ballkan dhe brenda aleancave perëndimore. Presidenti rus, Putin vështirë se i beson fatit.

Është një rëndësi të madhe fakti që BE-ja nuk e mbajti premtimin për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut për të filluar hapjen e negociatave, ashtu siç u rekomandua nga Komisioni Evropian", ka thënë Rasmussen.

Serbia heton një aferë të dyshuar spiunazhi ku është përfshirë një agjent rus



BEOGRAD, 20 NËNTOR - Autoritetet në Serbi, thanë se presidenti serb, Aleksandër Vuçiq, ka urdhëruar hetimin e raportimeve për një aferë të dyshuar spiunazhi, dyshimet për të cilën u nxitën nga video e postuar në rrjetet sociale, ku shihet një agjent i Shërbimit rus të zbulimit, duke i dhënë para një zyrtari të Shërbimit serb të sigurisë.

Një zyrtar i Agjencisë Informative dhe të Sigurisë së Serbisë, e njohur si BIA, i tha të mërkurën Televizionit shtetëror serb se video xhirimi është autentik. Videoja ishte postuar më 17 nëntor në kanalën YouTube. Aty shihet një diplomat rus duke i dhënë një çantë agjentit serb në Beograd, nga e

cila ky fundit nxori një zarf me para.

Ministri serb i Mbrojtjes, Aleksandër Vulin, i tha agjencisë serbe të lajmeve Tanjug, se gjatë 24 orëve të fundit janë zhvilluar një sërë takimesh me presidentin serb, Aleksandër Vuçiq rreth kësaj çështjeje dhe se më shumë informacione mund të priten të enjten, kur pritet të mblidhen shefat e shërbimeve të zbulimit dhe kundërspiunazhit. "Situata është serioze dhe komandanti suprem (presidenti Vuçiq) do të shpalosë përfundimet pas shqyrtimit të hollësishëm", tha ministri serb. Më herët gjatë ditës, mediet serbe cituan kryeministren Ana Bërnabiç të ketë thënë që "nëse

kjo del e vërtetë, do të jetë një problem i madh".

Mediet në Serbi thanë se presidenti serb do të diskutojë të enjten këtë çështje edhe me ambasadorin rus në Beograd, Alexander Bocan Harchenko. Ishte gazetari bullgar Christo Grozev, i cili shkroi në rrjetin Twitter gjatë fundjavës se në videon e publikuar në YouTube, shihet ish-ndihmësi i atasheut ushtarak në Ambasadën ruse në Beograd që po takohej me agjentin serb në një operacion të fshehtë.

Zyrtari i BIA-s serbe, Rela Zhelski, pohoi se në video shihet agjenti rus i zbulimit, Georgij Kleban, por nuk dha asnjë hollësi për agjentin e dyshuar serb.

Sot një vit nga vendosja e taksës 100 për qind ndaj mallrave nga Serbia dhe Bosnja

Më 6 nëntor të vitit të kaluar Qeveria në largim e Kosovës vendosi taksën prej 10 përqindësh për prodhimet me origjinë nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina, kurse më 21 nëntor kjo taksë u rrit në 100 për qind për të gjitha produktet dhe mallrat e importuara nga këto dy shtete. Me rastin e njëvjetorit të vendosjes së taksës këtë vendim vazhdon ta mbrojë kryeministri në largim, Ramush Haradinaj. Ai ka thënë se një vit më parë Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndërmarrë një prej vendimeve më të guximshme që nga shpallja e pavarësisë, me vendosjen e tarifës prej 100 përqindësh në mallrat e Serbisë si masë ndaj fushatës agresive të shtetit serb



EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, ka thënë se taksa 100 për qind ndaj Serbisë duhet të hiqet vetëm pasi të ndërpritet çdo agresivitet i Beogradit. Njëvjetorin e një shkrimi në llogarinë e vet në "Facebook", ai ka shkruar se kushdo nga shqiptarët, kudo që jetojnë a gjallërojnë ata, nëse nuk e dinë pse ka ardhur deri te taksa 100 për qind, ai apo ata nuk e dinë as kah kanë ardhur e as në ç'drejtim duhet të shkojnë. "Kushdo që kërkon heqjen e taksës sot, duhet ta dijë se kërkesa duhet t'i drejto-

het Beogradit zyrtar, që ai të distancohet qartazi nga politikat e gjenocidit e të agresioneve diplomatike të Beogradit ndaj Kosovës dhe të ardhmes së saj", ka shkruar Krasniqi. Ai ka shtuar se as rruga e luftës që zgjodhëm dhe as taksa e re që u vendos para një viti nuk ishin zgjedhje të dëshirueshme, por çështje të domosdoshme që na i pati imponuar Serbia e politikës së gjenocidit.

Krasniqi ka thënë se faji i politikës shqiptare nuk është vendosja e taksës, por vonesa e politikës sonë lakmitare për grabitje e jo për ndërtim të shtetit të së drejtës. "Taksa duhet të hiqet vetëm pasi të

ndërpritet çdo agresivitet i Beogradit", ka deklaruar ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi.

Me rastin e njëvjetorit të vendosjes së taksës, këtë vendim e ka mbrojtur kryeministri në largim, Ramush Haradinaj. Ai ka thënë se një vit më parë Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndërmarrë një prej vendimeve më të guximshme që nga shpallja e pavarësisë, me vendosjen e tarifës prej 100-përqindësh në mallrat e Serbisë, si masë ndaj fushatës agresive të shtetit serb. "Me këtë hap të rëndësishëm Kosova ka treguar se Serbia nuk mund t'i japë detyra, kurse miqve ndërkombëtarë se nuk i

nënshtroni shtetit serb. Vendosja e tarifës ndaj mallrave serbe, prej nëntorit të vitit të kaluar, ka ndikuar tej mase në fuqizimin e prodhuesve vendorë. Në thelb, ky veprim e ka delegitimuar projektin e ndarjes së Kosovës që fshihej nën idenë e korigjimit të kufijve. Kjo masë është dëshmuar strategjike dhe duhet të mbetet deri në njohje të shtetit të Kosovës", ka thënë Haradinaj. Më 6 nëntor të vitit të kaluar Qeveria në largim e Kosovës vendosi taksën prej 10 përqindësh për prodhimet me origjinë nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina, kurse më 21 nëntor kjo taksë u rrit në 100 për qind për të gjitha produktet

dhe mallrat e importuara nga këto dy shtete. Që nga 21 nëntori i vitit të kaluar vlera e produkteve të importuara nga Serbia në Kosovë është 4 milionë euro, kurse nga Bosnjë e Hercegovina, 2 milionë euro. Ndërkaq, eksporti i produkteve "Made in Kosova" gjatë kësaj periudhe në Serbi ka qenë 13 milionë euro, kurse në Bosnjë Hercegovinë 5 milionë euro. Përderisa në Kosovë nuk vërehet ndonjë mungesë e produkteve dhe as ndonjë ndikim në të hyrat doganore, humbjet e prodhuesve nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina arrijnë në qindra miliona euro që kur Qeveria e Kosovës vendosi taksë 100 për qind.

Ministri Tahiri: Është koha të lëvizim drejt anëtarësimit në Konventat e Hagës

EPOKA ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka hapur punimet e konferencës dypalëshe të organizuar nga Ministria e Drejtësisë së Kosovës në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë së Francës, për çështje të bashkëpunimit juridik në çështje civile. Në fjalën e tij, ministri Tahiri ka kërkuar nga Republika e Francës t'i shtojë përpjekjet për mbështetjen e anëtarësimit të Kosovës në Konferencën e Hagës dhe aderimin në Konventat e Hagës. "Republika e Kosovës është shteti më i ri në rajon dhe më gjerë, por për vetëm 11 vjet të shtetësisë ka arritur ta kapë trendin e zhvillimeve, e në raste specifike edhe t'i tejkalojë vendet e rajonit në raport me obligimet ndërkombëtare. Kosova, me institucionet e drejtësisë dhe punën që ka bërë, me theks të veçantë gjatë dy vjetëve të fundit në bashkëpunimin juridik penal, është dëshmuar se nuk do të jetë



asnjëherë adresë e strehimit të njerëzve që kanë rënë ndesh me ligjin dhe as nuk do t'i amnistojë individët që dyshohen për vepra penale jashtë vendit", ka thënë Tahiri.

Ai ka theksuar se krahas suksesit që po shënojmë në

bashkëpunimin juridik në çështje penale, si shoqëri dhe si shtet, po lëvizim gradualisht drejt integritimit ndërkombëtarë e evropiane, përballë të cilave, në radhë të parë përballë vetë qytetarëve tanë, duhet të marrim përsipër funksionimin e ligjit edhe

në çështjet civile. "Prandaj, trajtimi i bashkëpunimit juridik në çështje civile është dhe do të jetë prioritet i institucioneve tona në periudhën vijuese. Kjo konferencë si dhe përmbajtja e punimeve që do të shtrohen këtu synon ta rrisë dhe ta përmirësojë praktikën e

bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet civile, nga çështjet më madhore e deri tek ato më specifike. Ministria që unë drejtoj shpreh gatishtësinë për thellimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar me Ministrinë e Drejtësisë së Republikës së Francës çka do të kontribuonte dukshëm dhe do ta lehtësonte ekzekutimin e suksesshëm të kërkesave tona të ndërsjella për ndihmë juridike", ka deklaruar Tahiri.

Me këtë rast, ai ka rikthyer në vëmendje një çështje tepër të rëndësishme që është e nevojës të shtrohet në agjendën politike e institucionale ndërkombëtare sa i përket bashkëpunimit juridik. "Krahas bashkëpunimit bilateral me vendet që, mbi të gjitha, kanë interes drejtësinë, është koha dhe është e nevojshme të shtohen përpjekjet tona për t'u anëtarësuar në Konferencën e Hagës dhe për të aderuar në Konventat e Hagës që janë në interesin tonë reciprok", është shprehur ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri.

Flet për "Epokën e re", Valdete Daka

KQZ-ja padrejtësisht po akuzohet



Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Valdete Daka, i ka vlerësuar të padrejta akuzat ndaj këtij institucioni për zvarritje të procesit të zgjedhjeve të 6 tetorit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka deklaruar se KQZ-ja nuk po e zvarrit këtë proces, por është duke zbatuar vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP) për rinumërim, i cili është i obligueshëm. Sipas Dakës, vetë subjektet politike kanë kërkuar nga PZAP-i rinumërimin e kutive të votimit. Ajo ka pohuar se zgjedhjet e 6 tetorit kanë qenë mirë të organizuara. "Të gjitha çështjet që kanë ndodhur pas ditës së zgjedhjeve padrejtësisht i vihen si barrë KQZ-së, duke harruar se ato çështje janë ngritur nga subjektet politike dhe pastaj janë bërë temë e ankesave", ka thënë Daka

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Valdete Daka, i ka mohuar të gjitha kritikët për zvarritje të procesit zgjedhor të 6 tetorit. Ajo ka thënë se padrejtësisht po akuzohet ky institucion për këtë proces. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Daka ka thënë se KQZ-ja për procesin e rinumërimin të votave vetëm po e zbaton vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP). "Ajo që dua të them është se KQZ-ja padrejtësisht po akuzohet vetëm pse e kryen punën e vet. Dua t'ua rikujtoj të gjithë atyre që drejtojnë akuza ndaj KQZ-së, se vendimin për rinumërimin e këtyre vendvotimeve e ka marrë PZAP-i e ne vetëm jemi duke e zbatuar një vendim të një instance më të lartë", ka thënë Daka.

Ajo ka treguar se KQZ-ja i ka shpallur rezultatet dhe më pas partitë politike janë ankuar dhe kanë kërkuar rinumërim të votave. "Pas kësaj ankesë ka

ardhur një vendim i PZAP-it në bazë të të cilit jemi të obliguar t'i rinumërojmë 1 407 kuti të votimit. Ne nuk jemi duke e zvarritur këtë proces. Ne jemi duke e kryer punën tonë. Pra, jemi duke bërë rinumërimin që është kërkuar. Vetë subjektet kanë kërkuar që të bëhet rinumërimi dhe tash kur PZAP-i e ka aprovuar një kërkesë të tillë, ne akuzohemi se po e zvarritim procesin zgjedhor. Këtë nuk po mund ta kuptoj", ka deklaruar Daka.

Ajo i ka ftuar subjektet politike që menjëherë pas konstituimit të institucioneve të reja ta fillojnë reformën zgjedhore. Daka ka vlerësuar se vetëm një reformë e mirëfilltë zgjedhore do të mund t'i eliminonte të metat e këtij procesi. "Në mënyrë që në të ardhmen të mos kemi një proces i cili nuk do të zgjatë kaq shumë, duhet të kemi një reformë zgjedhore në të cilën do të qartësohen afatet ligjore për ankesat, arsyet për të cilat mund të bëhen ankesat apo të rregullohet më ndryshe procedura e ankimit. Po ashtu, në këtë reformë duhet të përfshihen edhe çështje të tjera që kanë dalë

në pah gjatë këtij procesi zgjedhor", është shprehur ajo, duke shtuar se KQZ-ja është e gatshme t'ua ofrojë subjekteve politike ekspertizën për këtë reformë. "KQZ-ja ka ekspertizë për këtë çështje, sepse ky institucion është duke i organizuar zgjedhjet prej vitit 2008 pa ndihmën e askujt. Pra, kemi organizuar më se 30 palë zgjedhje të ndryshme. Zgjedhje parlamentare, zgjedhje lokale dhe zgjedhje për kryetar të komunave. Të gjitha këto kanë bërë që ne të kemi një ekspertizë dhe një përvojë të jashtëzakonshme. Mos harroni se për zgjedhjet e fundit jemi marrë model për mënyrën se si janë organizuar zgjedhjet e 6 tetorit", ka deklaruar Daka.

"Epoka e re": Znj. Daka, si po shkon procesi i rinumërimin të votave të kërkuara nga PZAP-i dhe kur pritet të përfundojë ky proces?
Daka: Deri më tani ky proces është duke shkuar shumë mirë. Pra, nuk kemi ndonjë vonesë apo problem. Aktualisht është dita e tetë e rinumërimin të 1 407 vendvotimeve sipas vendimit të PZAP-it. Në Qendrën e

për zvarritje të procesit zgjedhor



Numërimit dhe Rezultateve puna është duke shkuar normalisht në prani të vëzhguesve të të gjitha subjekteve politike.

"Epoka e re": Zvarritja e procesit zgjedhor përmes rinumërimit ka nxitur kritika të shumta edhe ndaj

KQZ-së. Si i keni parë këto kritika?

Daka: Ajo që dua të them është se KQZ-ja padrejtësisht po akuzohet vetëm pse e kryen punën e vet. Do t'ua rikujtoj të gjithë atyre që drejtojnë akuza ndaj KQZ-së, se vendimin për rinumërimin e këtyre vendotimeve e ka marrë

PZAP-ja dhe ne vetëm jemi duke e zbatuar një vendim të një instance më të lartë. Pra, i kemi pasur rezultatet e gatshme dhe i kemi shpallur ato. Ndërkaq subjektet politike pastaj kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre për t'u ankuar. Pas kësaj ankese ka

ardhur një vendim i PZAP-it në bazë të të cilit ne jemi obliguar t'i rinumërojmë 1 407 kuti të votimit. Ne nuk jemi duke e zvarritur këtë proces. Ne jemi duke e kryer punën tonë, rinumërimin e votave ashtu siç është kërkuar. Vetë subjektet kanë kërkuar që të bëhet rinumërimi dhe tash kur PZAP-i e ka aprovuar një kërkesë të tillë, ne akuzohemi se po e zvarritim procesin zgjedhor. Këtë nuk po mund ta kuptoj.

"Epoka e re": Edhe më herët ka pasur kritika ndaj KQZ-së për shkak të gabimit teknik në formular. A e ka kryer KQZ-ja detyrën si duhet?

Daka: Natyrisht. KQZ-ja ka qenë në nivel të detyrës. Duhet të kujtoj se për shkak të atij gabimi teknik në formularët e rezultateve, me vendim të KQZ-së diku rreth 500 kuti janë rinumëruar, kurse të tjerat janë bërë për shkak të mospërputhjes matematikore në mes të votave të kandidatëve të subjekteve politike. Pra, nuk janë bërë me gabimin e KQZ-së, por me gabimin e komisionarëve të cilët janë të subjekteve politike. Kështu që, ne i kemi korrigjuar ato gabime të cilat i kanë bërë ata komisionarë të cilët, në fakt, janë militantë të partive politike.

"Epoka e re": Procesi i rinumërimit, sa mund ta lëndojë kredibilitetin e gjithë procesit zgjedhor?

Daka: Nuk po mund t'i kuptoj partitë politike. Në njërin anë kanë kërkuar rinumërimin e tash kur po bëhet rinumërimi po thonë se po lëndohet integriteti i zgjedhjeve. Këto subjekte politike kanë kërkuar rinumërimin e të gjitha kutive të votimit. Tash po veprojmë ashtu siç ka kërkuar PZAP-i dhe ashtu siç kanë kërkuar subjektet politike.

"Epoka e re": Nga përvoja e këtij procesi zgjedhor dhe atyre që janë organizuar deri më tani, cili është mesazhi juaj për partitë politike se çka duhet të bëjnë për

zgjedhjet e ardhshme në mënyrë që këto gjëra të mos përsëriten?

Daka: Në mënyrë që në të ardhmen të mos kemi një proces i cili nuk do të zgjatë kaq shumë, duhet të kemi një reformë zgjedhore në të cilën do të qartësohen afatet ligjore për ankesat, arsyet për të cilat mund të bëhen ankesat apo të rregullohet më ndryshe procedura e ankimit. Po ashtu, në këtë reformë duhet të përfshihen edhe çështje të tjera që kanë dalë në pah gjatë këtij procesi zgjedhor, si votimi me postë dhe çështje të tjera të cilat ndërliken me votimin jashtë Kosovës. Pra, të gjitha këto duhet të jenë tema për reformën zgjedhore pasi të konstituohen institucionet e reja. Mesazhi im për subjektet politike është që sa më parë të bëhet reforma zgjedhore, të zgjidhen njëherë e përgjithmonë këto dilema dhe këto anomalitë që kanë dalë në pah gjatë këtij procesi zgjedhor.

"Epoka e re": Çfarë ndihme mund t'u japë KQZ-ja subjekteve politike në këtë drejtim?

Daka: KQZ-ja ka ekspertizë për këtë çështje sepse ky institucion është duke i organizuar zgjedhjet prej vitit 2008, pa ndihmën e askujt. Pra, kemi organizuar më se 30 palë zgjedhje të ndryshme. Zgjedhjet parlamentare, zgjedhjet lokale dhe zgjedhjet për kryetarë të komunave. Të gjitha këto kanë bërë që ne të kemi një ekspertizë dhe një përvojë të jashtëzakonshme. Mos harroni se për zgjedhjet e fundit ne jemi marrë si model për mënyrën se si janë organizuar zgjedhjet e 6 tetorit. Të gjitha çështjet që kanë ndodhur pas ditës së zgjedhjeve padrejtësisht i vihen si barrë KQZ-së, duke harruar se ato çështje janë ngritur nga subjektet politike dhe pastaj janë bërë temë e ankesave. Natyrisht se proceset zgjaten kur kemi ankesa dhe çështje të cilat pastaj duhet të veprohet sipas atyre ankesave.

Haradinaj: Kosova e gatshme për marrëveshje me Serbinë në kufijtë ekzistues

PRISHTINË, 20 NËNTOR (ER) - Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka pritëur të mërkurën në takim këshilltarin e lartë të Qendrës për Dialog Humanitar, Jean Marie Guéhenno, me të cilin ka biseduar për vazhdimin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Haradinaj ka thënë se Kosova është e gatshme për marrëveshje



gjithëpërfshirëse me Serbinë, e cila është ligjërisht obliguese dhe që rezulton me njohje reciproke në kufijtë ekzistues. "Me këshilltarin e lartë të Qendrës për Dialog Humanitar, Jean Marie

Guéhenno, njëherësh ish-diplomat i shquar francez, këmbëzëm mendime për hapat e mëtejshëm për vazhdimin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Kosova është e gatshme për marrëveshje gjithëpërfshirëse ligjërisht obliguese, që rezulton me njohje reciproke në kufijtë ekzistues", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

28 nëntori, ditë pushimi në Kosovë

PRISHTINË, 20 NËNTOR (ER) - Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se ka marrë vendim që 28 Nëntori - Dita e Flamurit - të jetë ditë pushimi në

Republikën e Kosovës. "Me rastin e Ditës së Flamurit, mbështetur në Ligjin për Festat Zyrtare, kam marrë vendim që 28 Nëntori të shpallet ditë pushimi në territorin e Republikës së Kosovës, për t'i



respektuar vlerat e traditës kombëtare shqiptare. Vendimi, që 28 Nëntori të jetë ditë pushimi, është i motivuar nga aspekti historik, tradicional dhe politik", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndotja e ajrit në Kosovë po kërcënon shëndetin e qytetarëve

Kryeqyteti i Kosovës, Prishtina dhe disa qytete të tjera si Obiliqi, Mitrovica, Gjilani dhe Drenasi janë qytetet të cilat më së shumti përballen me nivel të lartë të ndotjes së ajrit. Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik ka theksuar se urgjentisht duhet të përpilohet një plan veprimi për përmirësimin e cilësisë së ajrit, sidomos në kryeqytet dhe të ndërmerren masa të tjera specifike

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Ndotja e ajrit në disa qytete të Kosovës ka arritur në nivele të rrezikshme për shëndetin e qytetarëve. Sipas të dhënave të autoriteteve në Kosovë, gjatë dy ditëve të fundit vlerat e PM 2.5 ishin mbi vlerat e lejuara.

Kryeqyteti i Kosovës, Prishtina dhe disa qytete të tjera si Obiliqi, Mitrovica, Gjilani dhe Drenasi janë qytetet të cilat më së shumti përballen me nivel të lartë të ndotjes së ajrit.

Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik paralajmëron për ajrin e ndotur në Prishtinë. Sipas këtij Instituti, urgjentisht duhet të përpilohet një plan veprimi për përmirësimin e cilësisë së ajrit sidomos në kryeqytet dhe të ndërmerren masa të tjera specifike. Instituti kërkon që të hiqen nga përdorimi veturat e vjetra dhe veturat pa katalizator si dhe inspektoratet e mjedisit ta bëjnë kontrollin rigoroz të kualitetit të karburanteve dhe konsumimit të lëndëve të ngurta djegëse që përdoren për ngrohje nga qytetarët. "Efektet afatshkurta të aerondotjes nga partikulat, sipas shumë të dhënave, na çojnë drejt rritjes së numrit të sëmurëve me astmë bronkiale, bronkrite kronike, sëmundje kronike obstruktive të mushkërive të moshat e shtyra, rritje të numrit të pranimeve

spitalore nga sëmundjet kardiovaskulare dhe ato respiratore, kancer, shkurtim të jetës dhe rritje të shkallës së mortalitetit", thuhet në njoftimin e Institutit të Shëndetit Publik.

Ndërkohë, qytetarë të anketuar nga "Radio Evropa e Lirë" shprehën të shqetësuar për nivelin e lartë të ndotjes së ajrit në Kosovë. Ilir Ahmeti thotë se niveli i lartë i ajrit të ndotur i pamundëson atij që të dalë në periudha të caktuara jashtë shtëpisë. "Nuk është që na tregojnë vetëm matësit e ndotjes së ajrit në qytet dhe në vende të

tjera, por e kemi parë edhe vizualisht, sidomos në mëngjes vërehet që është një perde e hirtë mbi Prishtinë dhe po të njëjtën kohë edhe pasdite vërehet edhe nga era e qymyrit. Këtu kanë faj edhe qytetarët që përdorin lëndë djegëse të cilat janë të dëmshme për ambientin, po ashtu edhe numri i madh i automjeteve në komunikacion", thotë ai.

Përkeqësimi i nivelit të cilësisë së ajrit, thotë qytetarja Hamide Zeneli, duhet t'i alarmojë institucionet e vendit pasi kjo gjendje, sipas saj, po ndikon drejtpërsëdrejti në shëndetin e njerëzve. "Niveli i lartë i ndotjes së ajrit po përsëritet vazhdimisht dhe askush nuk po ndërmerr masa nga institucionet përkatëse që duhet të merren me këtë problematikë. Po na pengon sepse ka viruse të ndryshme që po paraqiten çdo vit", thotë ajo.

Veturat e shumta, Korporata Energjetike e Kosovës, përdorimi i thëngjillit për ngrohje, kushtet e pafavorshme atmosferike nga

institucionet e vendit po konsiderohen faktorët kryesorë të ndotjes së ajrit në Kosovë.

Leutrim Sahiti, këshilltar politik i ministrit në detyrë të Mjedisit, tha për "Radion Evropa e Lirë" se kanë marrë masa për reduktimin e ndotjes së ajrit por që, sipas tij, përveç institucioneve, edhe qytetarët do të duhej të kontribuonin për ruajtjen e cilësisë së ajrit. Ai u bënë thirrje qytetarëve që të mos ngrohen me thëngjill, por të përdoren lëndë të tjera djegëse më pak të dëmshme për mjedisin. "Në bashkëpunimin me Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale kemi ndërmarrë veprim për konfiskimin e thëngjillit ilegal që shitet në Kosovë, pasi dihet se në vendet ku nxirret ilegalisht thëngjilli në Kosovë, ai është i papërpunuar dhe paraqet rrezik mjaft të madh për shëndetin e qytetarëve. Fatkeqësisht, një pjesë e madhe e thëngjillit që shitet në tregjet e Kosovës është nga këto deponi", thotë Sahiti.

Veprimi më i madh që ka ndodhur

në këtë vit dhe që do të jetë vendimtar për reduktimin e ndotjes së ajrit, shton Sahiti, është ndërrimi i filtrave të Termocentralit Kosova B, projekt ky që do të zgjasë disa vjet, por me përfundimin e këtij projekti, thotë ai, do të ketë reduktim të ndotjes së ajrit në Kosovë. "Pas kësaj mbetet që të merremi me veturat dhe me thëngjillin. Ndalimi i përdorimit të thëngjillit tek ekonomitë familjare tani për tani është i pamundur derisa të mos u afrojmë atyre një alternativë tjetër për ngrohje. Ndërsa për veturat ne kemi nxjerrë një udhëzim administrativ për kontrollimin e gazrave që lirojnë. Presim që ky udhëzim administrativ të zbatohet sa më shpejt nga Ministria e Infrastrukturës", thotë Sahiti.

Për degradimin e mjedisit jetësor Kosova ishte kritikuar edhe nga mekanizmat ndërkombëtarë. Në raportet e këtyre mekanizmave, Kosova ishte renditur në nivelin më të ulët të standardeve mjedisore në Ballkanin Perëndimor dhe në Evropë.



Në Turqi fuqizohet rrjeti i të rinjve dhe studentëve shqiptarë



PRISHTINË, 20 NËNTOR (ER) - Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike realizoi projektin "Krijimi dhe fuqizimi i rrjeteve të të rinjve dhe studentëve në Turqi". Në qytetin e Stambollit u zhvilluan takime me përfaqësuesit e Lidhjes së Rinisë Shqiptare të këtij qyteti. Në këto takime, në të cilat ishte i pranishëm kryetari i Lidhjes për Stamboll, Eni Balkan, u diskutua për zgjerimin e lidhjes edhe në qytete të tjera të Turqisë, për fuqizimin e saj dhe për konkretizimin e projekteve të ndryshme që lidhen me rininë. Përfaqësuesit e MDIS-it patën takime edhe me të rinjtë dhe anëtarët e Lidhjes së Rinisë

Shqiptare në Bursa. Aty i priti kryetaria e rinisë për Bursë, Nergis Morana, nga e cila u njoftuan për së afërmi për punën dhe aktivitetet e Lidhjes së Rinisë Shqiptare. Edhe në këtë takim u diskutua për fuqizimin dhe bashkëpunimin e mëtutjeshëm me MDIS-in. Vlen të theksohet se në takim me të rinjtë shqiptarë të Bursës ishte i pranishëm edhe ish-kryetari i qytetit të Bursas, Rexhep Altepe, i cili premtoi se do t'u ofrojë mbështetje të rinjve që veprojnë në këtë qytet. U zhvilluan takime edhe me përfaqësuesit e Shoqatës Kulturore "Zafer", e cila njihet për aktivitetet e saj jo vetëm në Bursa, por edhe më gjerë.

Në QKUK këtë vit u realizuan 3 500 procedura invazive

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Kongresi i parë për trajtim të hershëm të infarktut të miokardit është duke zhvilluar punimet në Prishtinë. Moto e këtij kongresi është "Koha shpëton jetë", kurse në të, përveç kardiologëve invazivë nga QKUK-ja, po marrin pjesë edhe profesorë dhe profesionistë nga vendet e tjera, po ashtu mjekë dhe infermierë të profileve të tjera.

Në fjalën e tij para të pranishmëve, drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, dr. Basri Sejdiu, ka shpjeguar vështirësitë, pengesat dhe rrugëtimin e gjatë deri në vënien e themeleve të Kardiologjisë Invazive.

Drejtori Sejdiu ka rikujtuar se në vitin 2003 ishte kryer koronarografia e parë nga ekipi vendor, pjesë e së cilës ishte edhe ai, kurse për shkak të pengesave që kishin, tek në vitin 2010 kishin vendosur stentin e parë në QKUK. Duke krahasuar shifrat ndër vite, ai ka theksuar se ka rritje të vëllimit të punës pasi që

tashmë ky shërbim punon 24 orë dhe trajton edhe rastet e infarkteve akute në dy orët e para. "Vitin e kaluar kemi pasur 2 500 procedura në Kardiologjinë Invazive dhe ky vit na gjen me 3 500 procedura invazive. Mund të themi se jemi në rrugë të mbarë që në Kosovë pacientët të trajtohen në mënyrë moderne, pra stentim në dy orët e para", ka thënë ai. Në anën tjetër, dr. Tefik Bektashi, drejtor i Klinikës së Kardiokirurgjisë me Kardiologji Invazive, ka thënë se nuk qëndrojnë keq sa i përket trajtimit të infarktut të miokardit, përderisa në konferencë kanë ftuar kolegë nga Sllovenia dhe Maqedonia për t'i bërë prezantimet dhe shkëmbimin e përvojave. "Vitin e kaluar kemi filluar të kujdestarojmë, të jemi prezent dhe gjithë pacientët që kanë pasur infarkt miokardi, ekipi ka qenë i gatshëm për intervenim, pra bëhet intervenimi përmes një shpimi në lëkurë, vjen deri në nivel të zemrës me mjete të ndryshme dhe rikanalizohet arteria, e cila fillimisht është mbyllur dhe është faktore e



infarktut të miokardit, i cili është prej sëmundjeve më vdekjeprurëse, që është një sfidë e madhe e mjekësisë moderne", ka sqaruar dr. Bektashi. Sipas tij, vdekshmëria e infarktut të miokardit përpara ka qenë

mbi 30 për qind dhe si Kosovë, sa i përket vdekshmërisë dhe trajtimit të infarktut të miokardit, jemi njëjtë me shtetet e tjera të botës.

Më tutje, drejtori i klinikës ka pohuar se ky projekt fillimisht ka

filluar në Prishtinë dhe në dy vjetët e ardhshëm do të zgjerohet në tërë Kosovën. Në konferencë po paraqiten prezantimet nga Sllovenia dhe Maqedonia, kurse prezantime pati edhe nga mjekët nga Kosova.

Nga 2 462 ndërmarrje të regjistruara, 96 për qind e tyre janë biznese të vogla

PRISHTINË, 20 NËNTOR (ER) - Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, mori sot pjesë në konferencën "Small-Scale Innovative Ecosystems in Kosovo", organizuar nga Ambasada e Finlandës në Prishtinë në bashkëpunim me UBT-në.

Në fjalën e tij para të pranishmëve, Haradinaj ka thënë se Kosova është para dy sfidave që i ka në vete, e që njëra ka të bëjë me urgjencën apo nevojën e zhvillimit ekonomik, presionit të madh që të nisemi në ekonomi ose edhe të rritemi, e dyta është kujdesi ndaj të gjitha vlerave apo ambientit ku ndodh kjo ekonomi. "Zakonisht ekonomitë në urgjencë të zhvillimit bëjnë kompromise të dhimbshme në ambient, resurse dhe në të gjitha aspektet e tjera rrethana. Për fat të mirë Kosova nuk është vetëm në këtë fazë të zhvillimit të vet dhe është vërtet për t'u falënderuar angazhimi i Ambasadës së Finlandës që është edhe kryesuese e BE-së që ka gjetur kohë, mundësi dhe resurse që ta përkrahë edhe një debat të këtyllë të zhvillimeve inovative, të bizneseve inovative dhe të efektit ose të aspekteve ekosisteme në Kosovë", u shpreh Haradinaj.

Gjatë fjalimit kryeministri në detyrë, Haradinaj, ka potencuar faktin se i mirëpresin këto energji që vijnë prej partnerëve, në këtë rast prej BE-së, UNDP-së dhe Amerikës. Haradinaj dha disa të

dhëna se çka ndodh në Kosovë me biznese, me ato që fillojnë, sa prej tyre janë dhe të çfarë veprimtarie janë. "Janë 2 462 ndërmarrje të regjistruara dhe 96 për qind e tyre janë biznese të vogla, të cilat janë në rrugë e sipër për ta zgjeruar veprimtarinë e tyre por, për fat të keq, nuk kemi pasur ndonjë kompani të regjistruar në vitin 2018 me mbi 250 të punësuar, që ta konsiderojmë si kompani të madhe. Më së shumti biznese operojnë në Prishtinë me 705 ndërmarrje, për të pasuar me Ferizajin me 224, Prizreni 208, Peja 147, Gjilani 144 dhe Gjakova 113", u shpreh kryeministri në detyrë, Haradinaj, duke shtuar se me ngritjen e vetëdijes sonë, me këto diskutime ne po e ndërlidhim urgjencën për zhvillim që e kemi dhe po në të njëjtën kohë po e kemi fatin që të kemi partnerë që na kujtojnë edhe aspekte të tjera që duhet pasur parasysh.

Edmond Hajrizi, rektor i UBT-së, tha se bashkëpunimi i mirë me Ambasadën e Finlandës, me ambasadorën, tregon një leadership, një proaktivitet, një dëshirë që të bashkëpunojnë dhe të zhvillojnë diçka bashkë në Kosovë dhe motivimi i kësaj konference është bazuar në atë që Finlanda e kryeson Bashkimin Evropian në këtë gjashtëmujor dhe ka si fokus pjesën e zhvillimit të qëndrueshëm, pjesën e ekosistemit, të ambientit, disa elemente të rëndësishme që janë parakusht i mirë i zhvillimit. Ambasadorja e Finlandës në Kosovë, Pia Stjernvall, tha se është mirë që sot ka ide se çfarë lloj ekosisteme inovative mund ta bëjnë ngritjen ekonomike dhe sociale në Kosovë. Ajo ka pohuar se kur ndërtojmë këtë lloj të ekosistemeve duhet të kuptojmë se duhet ta kemi përkushtimin e gjithë aktorëve të mundshëm.



Thaçi ndan dekoratë për Zyrën e Bankës Botërore në njëzetvjetorin e saj në Kosovë

Prishtinë, 19 nëntor (ER) - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, në njëzetvjetorin e Zyrës së Bankës Botërore në Kosovë dhe në dhjetëvjetorin e anëtarësimit të Kosovës në Bankën Botërore, Zyrës së Bankës Botërore në Kosovë i ka ndarë Medaljen Presidenciale të Meritave. Kjo dekoratë i është dorëzuar drejtoreshës Regjionale të Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor, Linda Van Gelder. "Bashkëpunimi në mes të

Kosovës dhe Bankës Botërore ka qenë jashtëzakonisht i mirë dhe të gjitha projektet e financuara nga Banka Botërore kanë dhënë rezultate shumë të mira në ekonominë dhe shoqërinë tonë. Ato kanë ndikuar në stabilitetin financiar dhe në rritjen ekonomike të Republikës së Kosovës", ka thënë Thaçi. Medalja Presidenciale e Meritave i është dhënë Zyrës së Bankës Botërore në Kosovë për kontributin e saj në zhvillimin ekonomik.

Bota rreth nesh po ndryshon, po ne a po e kuptojmë?



Shkruan: Valon MURATI

Në nivelin global dhe atë rajonal, së paku prej krizës së vitit 2008, kemi lëvizje të rëndësishme gjeo-strategjike. Këto si kurrë më parë janë ndjerë vitet e fundit, sidomos këtë vit. ShBA-ja ka ndryshuar disa prej politikave të veta në Lindjen e Mesme dhe në Azi (njohja e Jerusalemit si kryeqytet i Izraelit, njohja e ndërtimeve të vendbanimeve të kolonëve izraelitë në Bregun Perëndimor, vendimi për tërheqjen e trupave nga Siria, përpjekjet për një marrëveshje me talibanët në Afganistan, me Korenë e Veriut si dhe acarimi me Iranin).

Në anën tjetër, Evropa vazhdon të jetë në një krizë të thellë institucionale dhe identiteti. Leximi me kujdes i intervistës së Makronit për 'The Economist' sqaron se veprimet e Francës në kuadër të BE-së sa i përket rajonit tonë (përfshirë këtu edhe dokumentin pesë faqesh non-paper për kushtet e reja që duhet të vlejnjë për anëtarësim në BE) nuk janë të rastësishme, por pjesë e një përpjekjeje për ta ripozicionuar krejtësisht projektin evropian në raport me ShBA-në, Rusinë e Kinën e duke i dhënë përparësi projektit politik, ushtarak e teknologjik, duke mos e lënë idenë e BE-së të vërtitet vetëm rreth tregut të përbashkët si vlerë supreme. Njëkohësisht, kemi ngritjen e së djathtës ekstreme në Evropë e cila po i fuqizon pozitat dhe po dëmton partitë tradicionale të moderuara, si dhe procesin e Brexitit që po lë dhe do të lë vrage në projektin evropian. Kina po forcohet, Rusia po

rikthehet fuqishëm në arenën ndërkombëtare si lojtar me ndikim, duke pasur dorë të fuqishme si aktor edhe në rajonin tonë. Ndërsa ku po mbetemi ne? Kosova e mbërthyer në kriza të brendshme për shkak të një klase politike të papërgjegjshme, as nuk po çon kokën t'i shoh këto ndryshime dhe të përfitojë e të punojë për zgjidhjen e problemeve të saj. Bota po kalon në një periudhë kur ka lëvizje nga pozicionet e politikave tradicionale, të cilat nuk janë të momentit, siç mundohet dikush t'i interpretojë, por shumë më strukturore. Në vend se të shfrytëzohet ky moment për t'i zgjidhur problemet me Serbinë e të shfrytëzohet interesimi amerikan por edhe ai evropian për të arritur marrëveshje me Serbinë, që përmes ripërcaktimit të kufijve do të hapte mundësitë që Kosova të shndërrohej në një shtet me sovranitet të plotë e integrim në organizatat kryesore

botërore, dalje nga izolimi e madje edhe mundësi bashkimi me Republikën e Shqipërisë, ne po sillemi si të vetëmjaftueshëm, duke rrezikuar të lëshojmë këtë moment nga duart e të futemi në një qorrsokak të status-quos. Mosshfrytëzimi i kësaj situatë do ta rrezikojë Kosovën me një destabilitet afatgjatë me mundësi shndërrimi në një shtet e shoqëri të izoluar e në konflikt të vazhdueshëm të brendshëm e të jashtëm. Në këtë rast, çmimi që do paguanim si shoqëri për mirëqenien, zhvillimin ekonomik, sundimin e ligjit e qeverisjen e mirë do të ishte shumë i lartë. Sot, kur bota po i kthehet asaj që presidenti Makron e quan "gramatika e fuqisë dhe sovranitetit", ne vazhdojmë të mbesim peng i Pakos së Ahtisaarit, mentalitetit feudal të udhëhequr nga ideja absurde e kosovacentrimit, copëzimit tonë kombëtar në kohën kur vetëm si shqiptar mund t'i bëjmë

ballë sfidave të tjera identitare, luftimit të idesë së bashkimit kombëtar në momentin kur ky edhe mund të realizohet dhe është i vetmi projekt që mbron sigurinë tonë, mirëqenien, balancën e raporteve të forcave në rajon dhe mund t'i jap shtysë një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm. Ende kemi kohë. Ende kemi kohë përderisa ShBA-të vazhdojnë të pohojnë se një marrëveshje Kosovë-Serbi është interes strategjik i saj si dhe përderisa edhe shtetet kryesore evropiane janë të vetëdijshme për nevojën që përmes një marrëveshjeje Kosovë - Serbi të zbehet ndikimi rus në Ballkan. Por, me këtë sjellje tonë, mund të paguajmë çmim më të lartë sesa do të paguanim nëse do të ishim në krye të detyrës, t'i kuptonim drejt rrethanat ndërkombëtare dhe t'i vendosnim interesat Kosovës dhe të kombit mbi ato personale, ekonomike, klanore, provinciale, e partiake.

Situata e sigurisë vlerësohet e qetë në Rahovec



RAHOVEC, 20 NËNTOR (ER) - Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) në Komunën e Rahovecit të mërkurën ka mbajtur mbledhjen e rregullt të cilën e ka kryesuar kryetari Smajl Latifi. Në këtë mbledhje u tha se gjendja e sigurisë është e qetë dhe e qëndrueshme në gjithë territorin e komunës.

Latifi në hapje të mbledhjes i ka informuar anëtarët dhe monitoruesit e KKS-së, siç janë OSCE-së dhe LMT-së në Rahovec,

se nga zyrtarët përgjegjës për sigurinë në gjithë territorin e komunës, situata është e qetë dhe e qëndrueshme. "Nëse anëtarët e KKS-së më drejtohen me kërkesë që t'u revokohet leja e punës për lokalet që gjatë natës e prishin rendin dhe qetësinë publike, do të bëjë një gjë të tillë dhe krejt kjo do të bëhet duke u bazuar në ligjet që janë në fuqi. Në të ardhmen do të rritet roli i anëtarëve të KKS-së në mënyrë që të ndikohet në rritjen e sigurisë

publike në Komunën e Rahovecit", ka thënë Latifi, duke shtuar se komuna që drejton është përgatitur për sezonin dimëror. Fazli Morina, komandant i Stacionit të Policisë në Rahovec, ka folur për situatën e sigurisë në përgjithësi për muajt shtator-tetor 2019, duke thënë se situata e sigurisë në përgjithësi është e qetë, por ka kërkuar bashkëpunim më të madh me qytetarët. "Situata e sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit për periudhën

kohore dymujore shtator-tetor 2019 ka qenë e qetë. Gjatë kësaj kohe janë regjistruar gjithsejtë 100 raste, prej tyre 81 vepra penale, 19 incidente të ndryshme. Nga këto mund t'i veçojmë disa vepra të rënda: lëndime të rënda 2 raste, vjedhje 14 raste, vjedhje të rënda 11 raste dhe 7 raste janë dhunë në familje. Policia e Kosovës në vazhdimësi është përkushtuar për sigurinë në shkollë. Lidhur me këtë është implementuar plani operativ në vazhdimësi 'Siguria në shkollë',

duke patrulluar në afërsi të objekteve të shkollave me automjete zyrtare, duke angazhuar zyrtarë në rroba civile, duke mbajtur takime dhe kontakte të vazhdueshme me drejtorët dhe zyrtarët e tjerë të shkollave përkatëse", ka thënë komandanti Morina. Në fund të mbledhjes është aprovuar Plan i Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2020. Në kuadër të këtij plani janë paraparë të mbahen gjashtë mbledhje.

Nga skema e ndihmës sociale përfituan 24 526 familje

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar raportin "Statistikat e mirëqenies sociale" për tremujorin e tretë (TM3) 2019. Ky publikim ofron të dhëna për numrin e përfituesve nga skema e ndihmës sociale, skema e pensioneve bazë të moshës, të pensioneve kontributpaguese të moshës, skemën e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara, skemën e pensioneve për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, skemën për mbështetje materiale për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme, skemën për pensionet familjare, skemën për pensionet invalide, skemën e pensioneve për familjet e dëshmorëve, invalideve të luftës dhe veteranëve të luftës, skemën e pensioneve të

"Trepçës", skemën e pensioneve për Trupat Mbrojtëse të Kosovës, të Forcës së Sigurisë së Kosovës, skemën e kompensimeve për personat e verbër, të dhëna për numrin e fëmijëve të braktisur etj.

Sipas rezultateve të dalta nga ky publikim rezultojnë se nga skema e ndihmës sociale kanë përfituar 24 526 familje me gjithsej 99 718 anëtarë, nga skema për mbështetje materiale familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara kanë përfituar 2 193 familje. Ndërkaq, nga skema e pensioneve bazë të moshës janë 13 1461 përfitues, nga skema e pensioneve kontributpaguese të moshës janë 46 980 përfitues, nga skema për pensionet familjare janë 3 903 përfitues, nga skema për pensionet invalide janë 106 përfitues, nga skema për pensionet e "Trepçës" janë 2 697 përfitues, nga skema e pensioneve të Trupave



Mbrojtëse të Kosovës janë 1 084 përfitues, nga skema e pensioneve për Forcën e Sigurisë së Kosovës janë 542 përfitues, nga skema e kompensimeve për personat e verbër janë 1 932 përfitues, nga skema e

pensioneve për personat me aftësi të kufizuara janë 17 883 përfitues, nga skema për pensionet e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë janë 3 107 përfitues. Sipas këtij raporti, nga skema për familjet e dësh-

morëve dhe invalidët e luftës janë 13 417 përfitues dhe nga skema për veteranët e luftës janë 38 120 përfitues. Kurse sa i përket braktisjes së fëmijëve, sipas ASK-së, në TM3 2019 janë braktisur shtatë fëmijë.

KMDLNj fton qytetarët të protestojnë kundër shtrenjtimit të sigurimit të veturave

PRISHTINË, 20 NËNTOR (ER) - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka kundërshtuar rritjen e taksës për sigurim të automjeteve nga kompanitë e sigurimeve.


KMDLNj ka theksuar se përgjegjës kryesor për rritjen e taksës për sigurimin e automjeteve është Banka Qendrore e Kosovës (BQK), e cila, sipas këtij këshilli, në vend se ta luajë rolin e rregullatorit të këtyre kompanive, është duke u bërë pjesë e zhvatjes aktive të buxhetit të qytetarëve të Kosovës. Në këtë kontekst, KMDLNj ka ftuar qytetarët të protestojnë kundër këtij vendimi dhe t'i mbrojnë të drejtat e tyre. "Në shumë vende të

botës nëse i keni dy vetura dhe nuk i përdorni çdo ditë, me një palë tabela mund t'i ngasin veturat duke i zhvendosur sipas nevojës, nga njëra veturë në tjetrën", është thënë në reagim KMDLNj-së.

Sipas këtij reagimi, ulja e çmimeve tarifore për sigurim dhe regjistrim të automjeteve mund të ndikojë në zvogëlimin e numrit të 100 mijë veturave të pasiguruara dhe të paregjistruara. "Rritja e paralajmëruar e tarifave nga kompanitë e sigurimeve, me pëlqimin diskriminues të BQK-së vetëm sa do ta rrisë numrin prej 100 mijë automjeteve të pasiguruara dhe të paregjistruara", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Apel nga Ujësjiellësi: Mos hidhni mbeturina në rrjetin e kanalizimit!

PRISHTINË, 20 NËNTOR (ER) - Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Prishtina" sh. a. (KRUP) ka njoftuar konsumatorët në zonën e shërbimit se muajin e kaluar është intervenuar në rreth 400 raste, zhbllkime të pusëve të ujërave të zeza, pastrim i pusëve dhe vendosje të kapakëve të pusëve në tërë zonën e shërbimit. "Lusim qytetarët të kenë kujdes dhe mos të hedhin gjësende të ngurta, mbeturina, gjëra ushqimore të mbetura jashtë përdorimit, të cilat janë të papërbalueshme për një sistem të kanalizimit i cili nuk është i dedikuar për gjëra të panevojshme ngaqë po e dëmtojnë rrjetin e kanalizimit duke krijuar vështirësi për punëtorët tanë në zhbllkimin e tyre. Rastet e tilla zhbllkohen çdoherë nga ana e ekipeve të mirëmbajtjes së rrjetit të ujësjiellësit, por mbeturinat e llojeve të ndryshme (përzierja e yndyrave dhe mbetjeve të tjera të lëngëta dhe të ngurta) po shkaktojnë shqetësime në shëndetin e tyre", është thënë në reagimin e Ujësjiellësit "Prishtina".



Emini-Kurteshi: 'Flaka e Janarit', manifestim që identifikon Gjilanin në aspektin kulturor

Gjilan, 20 nëntor (ER) - Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), nën drejtimin e Shpresa Kurteshit-Emin, ka shqyrtuar dhe rekomanduar për Kuvend Komunal propozim-rregulloren për tatimin në pronë për vitin 2020, harmonizimin brenda kategorisë së pagave në Komunën e Gjilanit, propozim-rregulloren për ndarjen e mjeteve financiare për ngritjen e shtatores së heroit "Agim Ramadani", propozim-projektin e përgjithshëm të manifestimit "Flaka e Janarit" 2020 si dhe informatën rreth PZhK-së dhe Hartës Zonale të Komunës. Komiteti në mënyrë unanime e ka rekomanduar propozim-projektin e manifestimit "Flaka e Janarit" 2020, që e ka prezantuar Deniza Limani, drejtoreshë për Kulturë, e cila ka thënë se tashmë është themeluar bordi dhe grupet punuese si dhe janë dorëzuar projektprogramet për

secilën shtyllë të manifestimit. Ndërkaq, duke u ndërlidhur me interesimet e opozitës, Nevzad Isufi (LV) e Riza Abdyli (PDK), rreth anës financiare si dhe konceptit të manifestimit që, siç u tha, ende mbetet sikurse në vitet e nëntëdhjeta, drejtoresha Limani tha se "Flaka... 2020" do të ketë disa ndryshime cilësore te secila shtyllë e saj, prandaj është rritur pak edhe kostoja. Ajo ka premtuar se të gjitha faturat e manifestimit do të sillen në Kuvend për diskutim të secilit shpenzim. Kurse Shpresa Kurteshi-Emini, kryesuese e Kuvendit, tha se "Flaka e Janarit" është manifestim unik kulturor, i cili mbështetet në katër shtyllat e tij kryesore që prej fillimit dhe kurrsesi nuk mund të tjetërsohet sepse vetëm si i tillë e identifikon Gjilanin. Synim i përhershëm mbetet ngritja e cilësisë, ka shtuar ajo.



Sa i përket rregullores së tatimit në pronë, sqarime ka dhënë drejtori i Buxhetit, Zijadin

Maliqi, i cili ka thënë se nuk ka ndryshime prej viteve të kaluara, duke nënvizuar faktin se

Gjilani është komuna e vetme në Kosovë që ka normën më të ulët tatimore.



UNICEF-i hap Qendrën e Inovacionit për të rinjtë në Gjakovë

GJAKOVË, 20 NËNTOR (ER) - Krijimi i ambienteve, ku të rinjtë shoqërohen mes vete, njëkohësisht krijojnë projekte të reja, ndikon në mënyrë pozitive në një të ardhme të ndritur për ta. Ky është qëllimi i hapjes së qendrës "Innovation HUB Gjakova", projekt ky i mbështetur nga Zyra e UNICEF-it në Kosovë në bashkëpunim me Komunën e Gjakovës dhe (GWY) YMCA. "Faleminderit për këtë iniciativë të mirë! Jam shumë i

lumtur për një nismë të tillë, e cila do të jetë në shërbim të të rinjve tanë. Ju dëshiroj shumë suksese", është shprehur kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, gjatë ceremonisë solemne të hapjes së qendrës. "Innovation HUB Gjakova" i ka dyert e hapura për të gjithë të rinjtë që përmes saj të zhvillojnë projekte që nxisin dhe adresojnë përfshirjen sociale, zhvillimin e të rinjve, bashkëpunimin ndëretnik dhe vendimmarrjen.

Komuna e Suharekës dhuron 1 015 libra për bibliotekën e ShFMU 'Iliria' në Savrovë

SUHAREKË, 20 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, e ka vizituar ShFMU "Iliria" në fshatin Savrovë. Ai së bashku me drejtorin e Kulturës, Beqir Berisha, i kanë dhuruar 1 015 tituj librash për bibliotekën e kësaj shkolle. Muharremaj bashkë me nxënësit dhe stafin e shkollës së fshatit Savrovë i kanë vendosur në sirtarë këta libra për lexuesit. Gjatë qëndrimit në shkollë, kryetari Muharremaj ka thënë se 1 015 libra më shumë janë tashmë pjesë e bibliotekës së Shkollës Fillore "Iliria" në Savrovë. "Me nxënësit



së bashku i radhitëm sipas renditjes për lexuesit. Investimi për dije, duke krijuar kushte sa më të mira

në cilësi në mësim, do të mbetet angazhim i përhershëm", ka thënë kryetari Muharremaj.

Nis ndërtimi i dy fushave sportive në Deçan

DEÇAN, 20 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka marrë pjesë në inaugurimin e punimeve për ndërtimin e dy fushave sportive në fshatin Shaptej dhe Irzniq. Me këtë rast, Ramosaj ka uruar që nga këto fusha të dalin futbollistë që do të luajnë në stadiume të madha. "Së bashku me drejtorin e Departamentit të Sportit në MKRS, Ibër Alaj, deputetin Rasim Selmanaj dhe bashkëpunëtorë të tjerë, bëmë inaugurimin e dy fushave të sportit në fshatrat Shaptej dhe Irzniq. Ndër të mirat që kemi si popull, ne identifikoi-



hemi edhe si sportistë të zotë, andaj uroj që nga këto fusha të vogla të dalin futbollistë që do të

luajnë në stadiumet më të mëdha të botës!", ka shkruar Ramosaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Lagja "Dardania" bëhet me këndin e ri të lodrave

PRISHTINË, 20 NËNTOR (ER) - Fëmijët e lagjes "Dardania" në kryeqytet tani e tutje do ta kenë këndin e ri të lodrave. Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend

Ahmeti, ka thënë se ky është investim i domosdoshëm që të kemi shoqëri të shëndoshë në të ardhmen. "Më shumë lojë, argëtim e socializim për fëmijët që të


ndihen pjesë e komunitetit qysh në fëmijëri. Ky është investimi i domosdoshëm që të kemi shoqëri të shëndoshë në të ardhmen. Fëmijët e lagjes

'Dardania' tashmë e kanë këndin e ri të lodrave plot ngjyra", ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook" kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti.



OBELISKU I MIRËNJOHJES QË I MUNGON KOSOVËS (4)

Nisja e luftës ishte një mision i vështirë



Shkruan: Bedri ISLAMI

Kjo fillon e i bën ata më të besueshëm, heq prej tyre ndryshkun e mendimit se shqiptarët janë inatçorë, kokëshkrepur, mosdialogues, të paafte, se janë njerëz që kënaqen me krimin dhe se serbët janë të vuajturit në Kosovë. Nga mundësia e krijuar nga lobi shqiptar ata gjejnë rastin të dëshmojnë për krimet serbe në Kosovë, në shumë periudha; nga mosbarazia në jetë, edhe pse Kosova është plot resurse; ata ballafaqojnë mendimet e tyre për të ardhmen e Kosovës, të cilën e duan republikë të pavarur, por që ende nuk i kanë gjetur modalitetet.

Këtë hapësirë që e krijon lobimi shqiptar nuk mund ta kishte bërë asnjë urdhër zyrtar, asnjë vendim shtetëror, sepse këto janë gjëra që nuk kalojnë përmes urdhrave, por përmes besimit.

Pikërisht, besimin që kishin krijuar me autoritetet e tyre përfaqësuesit më të zëshëm të lobit shqiptar, e vendosën në themelin e njohjes së mendimit politik shqiptar në Kosovë, duke krijuar një lëvizje të dyfishtë: ardhjen e mendimit intelektual të shqiptarëve në Perëndim dhe dërgimin e njerëzve me emër të Perëndimit në Kosovë.

Kjo lidhje e dyfishtë, e bërë mbi besimin dhe financimin e këtij lobi, do të jetë edhe rruga e parë që ishte shtruar drejtë, me një mendësi krejt të re, të panjohur më herët në politikën shqiptare. Kjo ndodhi sepse në brumosjen e këtyre njerëzve që u morën me politikë kombëtare, me dëshirën e tyre dhe jo si profesionistë, ishte krijuar mendësia e qytetarisë, e bisedës, dialogut dhe, po ashtu, ishte rritur ndër vite figura e tyre si njerëz seriozë, miq ose kundërshtarë të denjë.

Porta e parë që u hap për lirinë dhe shtetin e ardhshëm të Kosovës zuri fill pikërisht në përpjekjet e para të këtij lobimi, në vitet e zanafillës, që duke qenë e tillë, ishte e vështirë.

Figura të shquara të shqiptarëve të Amerikës fillojnë e dritëzohen. Ata bëhen shembëlltyrë e një përpjekje vigane, të pashoqe, pa asnjë lloj interesi

financiar, veçori e skajshme e këtij lobimi dhe, njëkohësisht, mbështetës të çdo lloj lëvizje tjetër që mund të sillte pavarësinë e Kosovës.

Me figurën e tyre janë të lidhur edhe shumë emra të shquar të politikës së Shteteve të Bashkuara, të cilët, në një kohë të vështirë, u bënë zëdhënës të këtij lobi, njerëz të afert të tyre, si një pikë mbështetje për atë politikë që po ndiqej në Kosovë. Më pas, të njëjtët, ndoshta më të shumtë, do të bëhen mbështetës edhe të lëvizjes çlirimtare dhe, kjo ndodhte pasi ata e kishin qartësuar mendimin e tyre politik se, shqiptarët, në dhjetë vite, synuan të realizojnë ëndrrën e tyre përmes fjalës dhe, kur kjo nuk mbeti më asnjë mundësi tjetër, iu drejtuan luftës.

Nisja e luftës ishte një mision i vështirë. Megjithëse, synimi i saj, për një shtet të pavarur të Kosovës apo, edhe më tej, për bashkimin kombëtar, në gjithçka dukej i pamundur. Çlirimi i Kosovës nga pushtimi serb ishte vendosur edhe në programin politik të Organizatës së një grupi idealist shqiptarësh, Lëvizja Popullore e Kosovës, të cilën kam pasur nderin ta drejtoj në kohën e Luftës së Kosovës, të cilët besonin se kjo fillesë, do të sillte edhe ndërhyrjen e forcave të tjera perëndimore.

Si dukej dhe, si do të ndodhte më pas, ata nuk kishin qenë të gabuar në parashikimin e tyre të vitit 1993, në mesin e këtij viti, kur në Kuvendin e tyre, të quajtur Mbledhja e Katërt e Përgjithshme, përcaktuan vendimin për krijimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Serbët ishin të sigurt, që në ditët e para të lëvizjes alternative në Kosovë dhe, më pas, me shfaqjen e UÇK-së, se kishte një bashkëveprim të plotë midis shqiptarëve dhe ShBA-ve. Një ide të tillë e kanë pasur edhe disa qeveri të tjera perëndimore. Nga ana tjetër, shqiptarët e dinin se kishte një bashkëveprim të ngutshëm dhe të hershëm mes Beogradit dhe Moskës dhe se nuk mund të gjenin bashkëpunues më të mirë se sa shtetin amerikan, historikisht mbështetës i lëvizjeve për pavarësi dhe dukshëm kundër politikës hegjemoniste ruse në Ballkan. Kosova, sidomos Mitrovica, duhej të ishte kufiri jugor i ndikimit rus. Dhe ashtu ndodhi.

Politika serbe kishte bindjen se, mes shqiptarëve dhe politikës

amerikane, kishte gjithnjë një urë lidhje dhe se kjo urë do të jetë lobi shqiptaro amerikan, gjithnjë me ndikim të madh, i fuqishëm në mendimin politik dhe tepër i ndershëm për t'u korrptuar nga politika serbe.

Fillimi i luftës shfaqti një tipar tjetër të forcës së këtij lobimi. Figura vendosëse të këtij lobimi kishin krijuar lidhjet e tyre, disa më të hershme, si me presidentin Nikson, kujtoj këtu takimin e zotit Ekrem Bardha në Shtëpinë e Bardhë, i cili i kërkoi Presidentit Amerikan që të ndërmerre çdo akt të mundshëm për të ndaluar ofensivën e qeverisë së kolonelëve grekë për aneksimin e jugut të Shqipërisë, takim i cili, si u dëshmuar më pas, ishte ndjekur edhe Shërbimi i Sigurimit të shtetit shqiptar; takimet me presidentët Bush dhe Clinton, me senatorë dhe kongresmenë.

Dhjetëra figura të shquara, megjithëse përtej Atlantikut, e ndjenë shumë afër Kosovën, ajo u bë pjesë e tyre, mendim politik dhe veprim praktik, krijoji lidhje të reja, disa herë të furishme dhe shpesh herë të qëndrueshme; krijuan urat e një lidhje të ndërsjellë dhe Kosova tashmë ishte një çështje e hapur. Që duhej mbyllur, për të mos u hapur nga njëra dekadë në tjetrën.

Përmes figurës së tyre, ky lobim ndikoi në njohjen e duhur, të shpallur dhe të pranuar, të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në ditët e zhvillimit të luftës do të jenë disa mijëra shqiptarë nga Perëndimi, të cilët, të organizuar do të kthehen në Kosovë për të qenë pjesë e luftës çlirimtare.

Asnjë kthim i tyre nuk do të kishte jehonë më të madhe në të gjithë botën, se Batalioni "Atlantiku" i shqiptarëve të Amerikës dhe kjo, mbi të gjitha, ishte simboli i një shembulli të madh përkrahje në një shtet të fuqishëm, i cili do bënte edhe historinë e së ardhmes së Kosovës.

Batalioni "Atlantiku" ishte domethënia e madhe e shtrirjes së mendimit politik dhe ushtarak shqiptar përtej Oqeanit; përtej oqeanit si koncept gjeografik, por më tepër si mendësi politike.

Kalimi i "Atlantikut", edhe si forcë ushtarake, gjë që nuk mund të bëhej pa mbështetjen, qoftë të heshtur të politikës amerikane, ishte njëkohësisht edhe dëshmi se tashmë portat e Shtëpisë së Bardhë ishin hapur për të mos u mbyllur deri sa

çështja të zgjidhet në përputhje me konceptin Perëndimor të lirisë dhe të të drejtave të kombeve për mëvetësi.

Ideja e mëhershme, e papranueshme pak vite më parë, për dy shtete me të njëjtën kombësi, po tejkalohet ngutshëm dhe kjo do të ishte hera e parë që do të ndodhte në Evropën e bashkuar si koncept, por e ndarë nga përvojat historike.

Në ditët e zhvillimit të punimeve të Konferencës së Rambujesë, në shtabin e ngritur jashtë Kështjellës, si mbështetje e veprimeve të përbashkëta, të cilin e drejtoja ato ditë, ndoshta nga më të parët që erdhën si forcë përkrahëse ishin shqiptarët lobistë nga ShBA.

Mes njërës kontinent dhe tjetrit ishin mijëra kilometra, por kjo kishte qenë pengesë e papërfillshme, për të qenë pjesë e atyre ditëve kur gjërat do të vendosehin për një të ardhme historike të shqiptarëve si komb dhe të Kosovës si mëvetësi shtetërore. Në pak çaste u krijua një klimë e përbashkët pune, që, në një mënyrë ose në një tjetër, përfaqësonte mendësinë bashkuese të shqiptarëve, pavarësisht vendit ku jetonin, të shkuarës politike apo aspiratave të tjera.

Nuk do të mund të harroj kurrë ato ditë, kur sallat e Kështjellës përcillnin tek grupet jashtë saj shqetësimin e madh të së ardhmes, kur draftet e paraqitura, fillimisht si sekret i kështjellës, diskutoheshin me zjarr jashtë saj, kur mendimet përcilleshin brenda kështjellës dhe trazimet pas takimeve me diplomatë perëndimor, të cilët kërkonin ndikimin e strukturës politike, krijuese të UÇK-së, tek të deleguarit në Kështjellë.

Mjediset ishin bërë si një qendër e vetme, më shumë komunikuese se gjithçka tjetër, nga ku mund të shihej se Kosova e kishte një të ardhme të saj.

U jam kthyer shpeshherë atyre ditëve, së bashku me angazhimet e pashoqe, do të thosha, të jashtëzakonshme të politikës dhe diplomacisë amerikane, të cilat, para vetes dhe shpesh herë, bashkë me to, kishin paraqitjen e dinjitetshme të lobit shqiptar në Amerikë, si parathënia e një gjendje të re dhe si epilogu i shumë viteve të mundimshme, të cilat po çliroheshin nga ankthi i pushtimit të pazakontë serbomadhi.

Edhe sot mendoj se ky angazhim, që nga fillimi, tepër i

sinqertë, pa dorashka dhe përkëdhelje i politikës së ShBA ndaj Kosovës ka qenë dhe mbetet guri themeltar, e domosdoshmja dhe përcaktuesja e një lëvizje politike, në të dy krahët e saj, qoftë përmes lëvizjes paqësore, qoftë përmes luftës çlirimtare.

ShBA kishin qenë të sinqertë, të hapur, nxitës dhe të pranishëm, por kurrë nuk kishin thënë se lirinë dhe pavarësinë do e sillnin dhuratë.

Kosova nuk u përfshi dhe as nuk u thirr në Dayton. Ajo mbeti jashtë vëmendjes dhe në këtë mënyrë zgjoi kundërshtitë dhe shqetësimin, jo vetëm të politikës në Prishtinë, por edhe të lobit shqiptaro - amerikan, për të ndërtuar një strukturë tjetër të veprimtarisë lobuese të tyre. Në janar të vitit 1996, Rudolph Perina, shefi i Misionit diplomatik të ShBA-ve në Beograd dhe pjesëmarrës në Konferencën paqësore për Bosnjë-Hercegovinën, ndodhej në Prishtinë, në një takim me dyer të mbyllura me Kryesinë e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Lideri i saj, Ibrahim Rugova, duke përmbledhur gjithë shqetësimin që varej mbi politikën e Kosovës, e pyeti përse Kosova nuk ishte thirrur në Dayton dhe përse ajo, pikërisht ajo, kishte mbetur jashtë vëmendjes së politikës ndërkombëtare.

Zoti Perina, edhe pse e ndjente se shqiptarët ishin në të drejtën e tyre, iu përgjigj drejtpërsëdrejti, pa lënë asnjë mundësi për një interpretim vetjak, se "Në Dayton janë ftuar ata që kanë luftuar".

Si për t'ia vërtetuar zotit Perina se edhe në Kosovë mund të ishin pjekur për një luftë të re në Ballkan, kjo do të ishte e katërta për shtetin serb, një muaj më pas, në mënyrë të centralizuar, pra, në të njëjtën ditë dhe në të njëjtën orë, do të jenë njëkohësisht 12 aksione të UÇK-së, mbi kazermat dhe postat policore serbe të instaluar në Kosovë.

Ka pasur herë pas here vërejtje, sidomos nga analistë ballkanas, veçanërisht kroatë, përse Kosova nuk e hapi frontin e saj, që mund të quhej "Fronti i Jugut", pikërisht në kohën kur shteti serb ishte i angazhuar në një luftë tjetër, pikërisht në Kroaci, i cili mund të quhej "Fronti Perëndimor", duke e vënë makinerinë luftarake serbe mes dy zjarreve.

(Vazhdon)

Presidenti iranian shpall fitore ndaj protestave kundër qeverisë

TEHERAN, 20 NËNTOR - Presidenti iranian Hassan Rohani ka pretenduar të mërkurën fitore ndaj protestave për të cilat ka fajësuar armiqtë e huaj, transmeton media shtetërore. Protestat në Iran janë mbajtur së fundmi për shkak të rritjes së çmimit të naftës dhe për pasojë kanë vdekur dhjetëra persona. "Populli iranian ka shënuar sërish sukses në një test historik dhe ka treguar se nuk do të lejojë

armiqtë të përfitojnë nga situata, edhe pse mund të kenë ankesa për menaxhimin e shtetit", ka thënë Rohani, sipas transmetuesit shtetëror IRIB. Sipas këtij transmetuesi, mijëra iranianë u janë bashkuar marsheve pro-qeveritare në disa qytete të mërkurën, pasi organizata ndërkombëtare, Amnesty International ka thënë që më shumë se 100 persona kanë vdekur në protesta. "Protestat e

rastësishme pro-qeveritare të cilat po i shihni janë shenjë e madhe e fuqisë së popullit iranian", ka thënë Rohani. Irani ka kufizuar qasjen në Internet, duke e bërë gati të pamundshme për protestuesit që të postojnë video të protestave në rrjetet sociale. Sipas zyrtarëve, rreth 1 000 protestues janë arrestuar. Zyra e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut ka pranuar

raporte se dhjetëra persona kanë vdekur. Zemërimi në Iran është rritur për shkak të rënies së vlerës së valutës dhe rritjes së çmimit të produkteve bazike për jetesë, prej kur Shtetet e Bashkuara janë tërhequr një vit më parë nga marrëveshja bërthamore që Teherani ka nënshkruar me fuqitë botërore më 2015. Pas largimit nga kjo marrëveshje, ShBA-ja ka kthyer të gjitha sanksionet ndaj Iranit. Qeveria ka



thënë se rritja e çmimeve do të ndikojë në mbledhjen e 2.55 miliardë dollarëve në vit si subvencione për 18 milionë familje që kanë të ardhura të ulëta.

Demokratët në debatin presidencial të radhës në Atlanta

Dhjetë kandidatët demokratë kanë debatuar me njëri-tjetrin të mërkurën në Atlanta të Xhorxhias në garën presidenciale, e cila, kohët e fundit, është vënë në hije nga procesi hetimor për shkarkimin e presidentit Trump



UASHINGTON, 20 NËNTOR - Demokratët kanë zhvilluar debatin e tyre të pestë presidencial të mërkurën në Atlanta të Xhorxhias. Dhjetë kandidatët demokratë kanë debatuar me njëri-tjetrin në garën presidenciale, e cila, kohët e fundit, është vënë në hije nga procesi hetimor për shkarkimin e presidentit Trump në Uashington, ka njoftuar voa. Do të jetë një skenë me dhjetë kandidatë demokratë në Atlanta, të cilët do të përpiqen ta tërheqin vëmendjen e votuesve të partisë së tyre. Dy pretendentët kryesorë, ish-nënpresidenti Joe Biden dhe senatorja nga Masaçusetsi, Elizabeth Warren, kanë qenë në qendër të skenës. Por një kandidat që po tërheq më shumë vëmendje është kryebashkiaku i qytetit të South Bendit në Indiana, Pete Buttigieg. Anketat tregojnë se Buttigieg tani po udhëheq në

Ajova, shteti i parë ku zhvillohen zgjedhjet paraprake që fillojnë në shkurt. "Me rritjen e numrit të votuesve që dëgjojnë mesazhin tim, do të rritet edhe mbështetja dhe baza jonë", tha ai. Ish-nënpresidenti Biden vazhdon të kryesojë në sondazhet në nivel kombëtar dhe argumenton se ai do të ishte kandidati më i fortë në përballjen me presidentin Trump vitin e ardhshëm. "Kushdo nga ne që do ta marrë emërimin e Partisë Demokratë, presidenti i

ardhshëm është e sigurt se do t'i trashëgojë dy gjëra: një vend të përçarë dhe një botë në rrëmujë", tha Biden. Senatorja Warren gjithashtu mbetet në krye të kandidatëve demokratë, por kohët e fundit është detyruar të hidhet në mbrojtje të planit të saj gjithëpërfshirës për një program qeveritar të kujdesit shëndetësor. "Votoni për mua dhe ejani të luftojmë së bashku sepse kjo është koha jonë që të ëndërrojmë, të luftojmë fort dhe të fitojmë!", tha Warren.

Një pretendent i ri demokrat, që nuk do të jetë në debat është ish-gubernatori i Masaçusetsit, Deval Patrick, i cili njoftoi javën e kaluar se po hynte në garë. "Unë mendoj se kjo fushatë është një mundësi për t'i bashkuar njerëzit", tha ai. Edhe ish-kryetari i bashkisë së Nju Jorkut dhe miliarderi Michael Bloomberg mund të hyjë në garën për president. Hyrja e kandidatëve shtesë ngrë pyetje në lidhje me listën aktuale të konkurrentëve, thotë analisti Larry Sabato. "Është e qartë se shumë udhëheqës demokratë

janë të shqetësuar nga ata që kryesojnë deri tani. Secili prej kandidatëve ka probleme: disa janë të moshuar, ose shumë të rinj, me shumë përvojë ose me pak përvojë, dhe anojnë shumë nga e majta ose e djathta", tha Sabato. Tetë pretendentët e tjerë që do të jenë në skenë për debatin në Atlanta, janë senatori nga Vermonti, Bernie Sanders, senatorja nga Kalifornia, Kamala Harris, senatorja nga Minesota, Amy Klobuchar dhe senatori nga Nju Xhërsi, Cory Booker.

Papa Françesku viziton Tajlandën dhe Japoninë

BANGKOK, 20 NËNTOR - Papa Françesku ka mbërritur në Bangkok për të filluar një turne në Tajlandë dhe Japoni. Ai është në një mision, për të rritur moralin e bashkësive katolike të vogla të atyre vendeve dhe të flasë për çështje që përfshijnë trafikimin e qenieve njerëzore dhe paqen. Ai në Tajlandë do të

nxjerrë në pah admirimin e tij për paraardhësit misionarë të komunitetit, që i sollën besimin këtij kombi Budist shekuj më parë dhe duruan periudha persekutimi më vonë. Katolikët janë një pakicë e vogël, në vendin me shumicë Budiste dhe përbëjnë më pak se 1 për qind të popullsisë.

Vizita e Papa Françeskut përkon me 350-vjetorin e misionit të parë në Siam, emri i dikurshëm i Tajlandës. Ai do të takohet me mbretin, Maha Vajiralongkorn, kreun e klerit Budist të Tajlandës, si dhe udhëheqësit dhe studentët katolikë para se të shkojë në Japoni, më 23 nëntor.





AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperiencia jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

E jashtëzakonshme

Që pesë vjet gjejnë vazhdimisht pakot me para në rrugët e fshatit

Banorët e Kaunti Durhamit, një fshati në Angli, që në vitin 2014 gjejnë vazhdimisht paketa me kartëmonedha brenda, të hedhura nëpër zona të ndryshme të qytetit dhe i dorëzojnë në polici. Këtë vit janë gjetur katër të tilla që janë dorëzuar në polici. Në total deri më sot janë dorëzuar rreth 2 200 euro. Pakot lihen gjithnjë në vende të dukshme, në



zona të rrahura nga publiku, si trotuare dhe zbulohen gjithnjë nga banorët e fshatit të cilët i dorëzojnë në polici. Hetuesit nuk e dinë ende se kush i vendos pakot me para dhe as se për çfarë arsye, por ata falënderojnë banorët që i dorëzojnë.

FOTO E DITES



Elefantët gjatë festivalit vjetor në provincën Verilindore Tajlandeze. /AFP/

E rrallë

Tre policë nën hetim, korruptoheshin me ushqim falas në restorant

Tre policë janë vënë nën hetim pasi ka dyshime se kanë njoftuar pronarët e restoranteve dhe të akullloreve për kontrollin e papritura nga inspektorati dhe si shpërbllim kanë marrë ushqime dhe akulllore falas. Bëhet fjalë për disa restorante dhe dyqane të akullloreve më të njohura të Romës,



pranë Shatërvanit Trevi dhe Shkallëve Spanjolle, ku numri i turistëve është shumë i lartë. Policët dyshohen se kanë mbyllur njërin sy kur ka pasur parregullsi dhe kanë informuar paraprakisht për kontrollin e befta nga inspektorati i higjienës, duke u kursyer pronarëve gjoba të mëdha.

BARSOLETA E DITËS



- Mos ke rënë në gjumë?
- Po kush je ti që më pyet?
- Jam ai djali që para një jave t'i dhashë 100 euro.
- Më fal, por kam rënë në gjumë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora 14:00

ABOMINABLE 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 32 min

Rolet: Chloe Bennet, Tenzing Norgay Trainor, Albert Tsai, Eddie Izzard, Sarah Paulson, Tsai Chin, Michelle Wong, etj.
Regjia: Jill Culton



Çdo ditë në ora 16:00

TOY STORY 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.
Regjia: Josh Cooley



Çdo ditë në ora 18:00 dhe 20:00

MALEFICENT MISTRESS OF EVIL 3D

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 orë 58 min

Rolet: Angelina Jolie, Elle Fanning, Chiwetel Ejiofor, Sam Riley, Ed Skrein, Imelda Staunton, Juno Temple, Michelle Pfeiffer, etj.
Regjia: Joachim Ronning



Çdo ditë në ora 22:00

ZOMBIELAND DOUBLE TAP

Aksion/Komedi/Horror; 1 orë 39 min

Rolet: Woody Harrelson, Jesse Eisenberg, Emma Stone, Abigail Breslin, Rosario Dawson, Zoey Deutch, Luke Wilson, etj.

Regjia: Ruben Fleischer



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: **Kino ABC**.



DASHI

Mbase mbi disa argumente që nuk keni

dijeni nuk keni pse debatoni. Do të tregoni që jeni të painformuar mirë lidhur me tema të caktuara.



DEMI

Një ditë e tërë në shoqërinë e vetes

suaj sot mund t'ju bëjë veçse mirë. Ju shijoni të ecurit në rrugë shpenguar ose vajtja në aktivitete kulturore.



BINJAKËT

Edhe pse nuk keni gjithçka nën

kontroll, kjo nuk do të thotë që nuk menaxhoni dot punën tuaj. Jeni mjaft korrekt kur bëhet fjalë për profesionalizëm.



GAFORRJA

Nuk mund të lejoni që personat

tuaj të afërt të jenë neglizhentë me një çështje të caktuar. Falë ndërhyrjes suaj gjërat do të rregullohen.



LUANI

Keni shumë gjëra që kanë lidhje

me administratën sot për të mbyllur dhe do t'ju duhet ta nisni ditën më herët se zakonisht.



VIRGJËRËSHA

Nëse doni t'i vini nën presion

personat afër jush ose bashkëpunëtorët, sot do t'ia arrini qëllimit. Nuk është e thënë që kjo sjellje është e mirë.



PESHORJA

Njerëzit pranë jush e kanë harruar

sa person i bukur jeni në shoqëri. Kjo sepse ju jeni shmangur prej kohësh kontaktit me të tjerët.



AKREPI

Kushtet komode që keni pasur i keni

rifituar kohët e fundit dhe kjo gjë ju pëlqen të zgjasë sa më shumë. Do të kërkonit kontakte të reja.



SHIGJETARI

Keni rifituar terrenin e humbur në

një çështje personale. Kjo gjë ju ka bërë të bindeni që mjafton pak këmbëngulje dhe mund t'ia dilni.



BRICJAPI

Jeni pak të ndrojtur në kontaktin

e parë me të panjohurit. Më pas bëheni shumë shpejt protagonistët e situatave.



UJORI

Nëse nuk doni që dikush t'ju vërë me

shpatulla për muri dhe t'ju kërkojë llogari, duhet patjetër të përfundoni atë që keni nisur deri në mesditë.



PESHQIT

Ditët e fundit keni

hasur në pengesa që nuk ju kanë lejuar të shihni qartë sa i përket gjendjes suaj të rënduar shpirtërore.

Martin Garrix i jep fund lidhjes me të dashurën Charelle



Martin Garrix mund të jetë në krye të listave me performancë të jashtëzakonshme të muzikës elektronike dhe të valëzimit por, fatkeqësisht, me jetën e dashurisë ende qëndron larg. Kjo pasi Garrix raportohet se tani është ndarë nga e dashura Charelle. Të dy,

të cilët shpesh ishin parë të parë gjatë një marrëdhënieje të fortë dhe të dashur, kanë vendosur që gjërat t'i përfundojnë në emër të dashurisë. Sipas Dj të njohur holandez, ata kanë vendosur t'i ndajnë rrugët pasi "dashuria do të thotë të dëshirosh më të mirën për personin që e doni".




Kaia Gerber nis të vishet si i dashuri i saj

Ae kanë Kaia Gerber dhe Pete Davidson tashmë një dollap me rroba të përbashkëta? Pasi e kishte kaluar natën në festën pas shout "Saturday Night Live" bashkë me Pete Davidson që përflitet se është i dashuri i saj. Modeluesja 18-vjeçare është parë të nesërmen e veshur me rroba që pa dyshim

dukeshin se ishin marrë nga dollapi i Davidsonit. Gerberi kishte veshur një këmishë të kaltër shumë të gjerë mbi një duks ngjyrë të zezë, kapelën e të cilit e kishte vënë mbi kapelën e thurur ngjyrë të bardhë që e kishte kombinuar me pantallona të ngushta të zeza, çorape dhe atlete të ngjyrës së njëjtë dhe syze ovale.

Modeluesja Carol Dias: Dua të martohem çdo pesë vjet me Kakanë



Kaka dhe modeluesja Carol Dias u martuan të dielën, më 17 nëntor, në një ceremoni private. Çifti ka festuar me prindërit dhe me miqtë më të afërt. Më 30 nëntor, në Bahia, do të zhvillohet një ceremoni më e gjerë, ku do të jenë të pranishëm një numër

shumë më i madh të ftuarish. Carol është shprehur së fundmi se dëshiron të martohet çdo pesë vjet. "Është shumë bukur të martohesh, djema. Është një punë si në ferr, por shumë dëfryese. Dua të martohem çdo pesë vjet me Kakanë", ka thënë ajo.

Jennifer Anistoni, 20 milionë ndjekës në "Instagram"

Ajo theu rekord në "Instagram" kur iu bashkua këtij rrjeti social rreth më shumë se një muaj më parë. Jennifer Anistoni tashmë po feston arritjen e 20 milionë ndjekësve të saj, e këtë e dëshmoi me një postim mirënjohës. Anistoni me anë të këtij dedikimi u shpreh falënderuese ndaj fansave të saj për mbështetjen e tyre në "Instagram". Aktorja e "Morning Show", 50-vjeçare, ka argëtuar ndjekësit me postimet e saj zbavitëse qysh kur iu bashkua "Instagram"-it.



LIBËR I DHEMBJES DHE I KRENARISË

(Hanëmshahe Ilazi & Nusret Pllana, "Fëmijët martirë të Kosovës 1981-1999", Botoi: "Radio Kosova e Lirë", Prishtinë, 2019)



Prof. dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA

Që në fillim dua të them se për fëmijët është shkruar, shkruhet dhe do të shkruhet vazhdimisht. Për ta u shkruan libra e u xhiruan filma, të cilët temë trajtimi patën jetën dhe ngjarjet, të cilat përcjellin fëmijërinë e lumtur o të munguar të tyre. Por, vërtet, kjo vepër "Fëmijët martirë të Kosovës 1981-1999", e autorëve të devotshëm Hanëmshahe Ilazit dhe Nusret Pllanës, nuk ka të bëjë me asnjërën prej këtyre. Në këtë libër, thjesht, shpaloset krejt diçka tjetër nga ajo që jemi mësuar të lexojmë e të shohim në botën e qytetëruar.

Libri "Fëmijët martirë të Kosovës 1981-1999" është shkruar me një përkushtim të rrallë dhe me një kujdes të veçantë. Këta dy autorë, edhe pse me vokacion nuk janë historianë-shkencëtarë, por nuk janë as psikologë, por me punën e bërë kanë depërtuar thellë e më thellë në ndjeshmërinë e përmasës së tragjedisë të dhembjes sonë. Mos të harrojmë se, mbi të gjitha, Hanëmshahe Ilazi është nënë, e Nusreti Pllana, baba i mrekullueshëm, andaj, si çdo nënë tjetër dhe, si secili baba, e kanë ndjerë dhe e kanë përjetuar rëndë dhembjen e çdo nëne e prindi që kanë humbur më të dashurit e tyre.

Vepra "Fëmijët martirë të Kosovës 1981-1999" është një libër i lahtarisë dhe i kërdisë. Një libër që të shtangë posa ta lexosh titullin e që të nxitë të futesh në brendinë e rreshtave e të fletëve, me faktografi të shumta e të pamohueshme, me dëshmi të bollshme e fotografi fëmijësh që u vranë e u masakruan anekënd Kosovës mbi 1 432 fëmijë.

Të nderuar pjesëmarrës, Për dikë ndoshta është e pabesueshme, por faktet flasin për vërtetësinë e ngjarjeve makabre që u zhvilluan në truallin e përgjakur të Kosovës martirë që nga viti 1981 e deri më 1999, kohë që e përkufizojnë autorët.

Besoj se askush nuk e ka harruar se në Kosovë patëm një luftë jo të

zakontë dhe, me një okupues edhe më të pazakontë, do të thosha barbar. E si do të quheshin ndryshe ata që vrasin fëmijë - veç kriminelë.

A vriten fëmijët, bre?! do të pyeste poeti. Po në këtë libër është përgjigjja që të shtangë. Është dëshmia rrëqethëse e faktografuar të cilën autorët Hanëmshahe Ilazi dhe Nusret Pllana i kanë grumbulluar dhe i kanë sistemuar, duke na ofruar vetëm një pjesë të majës së ajzbergut të tragjedisë që ka ndodhur në Kosovë.

Kush i vret fëmijët, vallë?! do të pyeste çdo njeri që vërtet është njeri. E përgjigjja nuk është larg. Nuk është e panjohur!. Nuk është e paditur, nuk është enigmatike. Duhet lexuar librin e autorëve Hanëmshahe Ilazi dhe Nusret Pllana dhe aty do të gjeni shumë të dhëna, shumë dëshmi dhe shumë e shumë mallkime nga nënat dhe nga vetë historia. Libri është tmerrri vetë, por që në të njëjtën kohë të bën të ndihesh i revoltuar, i rebeluar, i mobilizuar, i rezistuar para së keqes dhe të mësohemi që më kurrë, kurr më, mos ta harrojmë të kaluarën, për

të mos u përsëritur, jo vetëm tek ne, por askund në botë.

Kush i vrau fëmijët, kush?! Do të pyeste çdo ndërgjegje njeriu dhe nuk është habi. O Zot, ata - vrasësit, na detyruan e na mësuan që ta urrenim edhe njeriun. I thonë njeri - vrasësit, apo jo?!

Të ndalemi për një çast dhe të mendojmë, se të gjithë ne jemi nënat, baballarët, motrat e vëllezërit e tyre. Jemi prindër që nuk i kemi më ato jetë të brishta. Nuk i kemi më puthjet dhe buzëqeshjet e tyre. Nuk na kthehen nga shkolla! Nuk na thërrasin për asgjë! Nuk na kërkojnë asgjë, por kujtimi për ta... hëmë, nëpër vite e dekada do të na përcjellë dhembje migrenoze nga ecejaket e lodhura në trotualet e historisë, që kërkojmë vetëm pak për ta, një vëmendje sublime nga gjenerata e gjenerata që do të vijnë.

Tematika e kësaj monografie është trajtuar me seriozitet të madh publicistik-shkencor. Secila pjesë ndërlihet reciprokisht mes vete dhe plotësojnë kuptimin e njëra-tjetrës. Statistikat që prezantohen këtu

janë të sakta, ku paraqiten me emra e mbiemra, me vendlindje e komuna, me vendndodhje të masakrave, andaj libri është monument shkrimi argumentues dhe bindës. Në fillim është dhënë përmbajtja e librit, pastaj dy fjalë lexuesit, më tutje fjalë e redaktorit e recensuesve. Pastaj pason hyrja dhe shumë pjesë të tjera. Në fund jepet përfundimi i librit, i cili njëherësh është i përkthyer edhe në gjuhën angleze.

Libri ka foto e faksimile, që është pjesa më rrëqethëse e tij, ku janë materializuar me fakte ngjarjet që trajtohen në këtë monografi. Autorët e librit "Fëmijët martirë të Kosovës 1981-1999", Hanëmshahe Ilazi dhe Nusret Pllana, me punën e tyre të pandalur na dhuruan këtë libër - lapidar për fëmijët e vranë në Kosovë, që nga viti 1981 deri në vitin 1999, i përgëzoi për kurajën që kanë pasur, ngaqë në momentet kur e lexoja librin ndihesha pjesë e tyre, kam qenë në pozitën e tyre dhe e di se çka kanë ndjerë, se sa vështirë e kanë pas t'u 'rezistojnë' ballafaqimeve me familjarët e fëmijëve martirë,


për t'ua kërkuar atyre qoftë edhe një fotoportret të fëmijës së tyre të vranë, apo të zhdukur, këtu e njëzetë vjet më parë.

Autorët kanë bërë punë të madhe, kombëtare dhe humane, ngaqë pjesën më të pastër e më të mirë, të qenies sonë, e kanë nxjerrë nga harresa. U kanë vënë emra dhe mbiemra. Ua kanë dhënë vendin e merituar në piedestalin e monumentit kombëtar të të rënëve për liri dhe pavarësi.

Libri "Fëmijët martirë të Kosovës 1981-1999", le të jetë edhe një homazh kombëtar e njerëzor për jetën e atyre fëmijëve që u shuan në mënyrë të pafajshme nga dora barbare. Le të jetë një dëshmi e paharruar e një kujtese të dhembshme, jo për hakmarrje, por që krimet mos të përsëriten kurrë më në trojet shqiptare e askund në botë.

Dhe krejt në fund i përgëzoj të dy autorët për punën e madhe që kanë bërë.

(Fjalë nga promovimi i librit "Fëmijët martirë të Kosovës 1981-1999", Prishtinë, 19 nëntor 2019)



Takimi me George Steinerin, Ismail Kadare dhe dy kushtet për Nobelin!



George Steiner është kritik letrar, filozof, romancier etj. Disa letrarë e filozofë sot e karakterizojnë Steinerin si poliglotin dhe polimatin më të madh të kohës sonë. Si profesor i Letërsisë Krahasimtare dhe i Filozofisë, Steiner ka ligjëruar pothuaj në të gjitha universitetet elitare të botës. Ai është autor i një varg librash të cilësuar, ku ndër më të njohurat janë: "Tolstoy or Dostoyevski", "The death of Tragedy", "In Bluebirds Castle", "No Passion Spent", "After Babel" etj.

Disa ekspertë kanë bërë me dije se Steiner mëton ta zëvendësojë Isaiah Berlinin, duke e imituar jetën dhe veprimet e tija, por se nuk e arrin dot. Megjithatë, Steiner, në fushën e letrave, është autoritet i pakontestuar.

Nuk kam nevojë ta prezantoj Ismail Kadrenë, por rreshtat më poshtë mund t'ju ndihmojnë në sqarimin e pyetjes: Pse Kadare nuk e merr Çmimin Nobel?

Më duket se ka qenë pranverë e vitit 1997 kur Blerim Shala, kryeredaktori i Javores Politike Shqiptare - "Zëri", kërkoi nga unë që ta intervistoj George Steinerin. Unë nuk dija shumë për Steinerin. E dija që merrej me letërsi e me filozofi, por nuk i kisha të qarta përmasat e punës së tij. Shkova në bibliotekën e afërt të lagjes, pasi atëherë Google ishte në fazë eksperimentale dhe nuk dihej që ekzistonte. Ndërkaq, interneti atëherë nuk ishte sikur sot.

Por, Steiner më ndihmoi që të mësoja edhe më shumë për të. Në telefon pranoi që ta intervistoj, por me një kusht: vetëm nëse, para intervistës, e lexoja librin e tij të quajtur "Errata - an examined life". Ishte një libër, një lloj autobiografie e tij, që mbahet në mend për kohë të gjatë dhe që të njofton me aftësitë e shkruarit dhe thellësitë e trajtimit të çështjeve. Libër që nuk ka shumë fletë, por që shpjegon shumë probleme të jetës së njeriut.

Nuk më kujtohen të gjitha detajet e intervistës, por Steiner ishte njeri i cili lë përshtypje madhështore edhe në shikim të parë. Kur hyra në zyrën e tij që e kishte në Universitetin e Kembrixhit ku ligjëronte atëherë, përshtypja e parë ishte pamja fizike e tij: gjatësia e trupit dhe veshja elegante. Ai atëherë ishte në të gjashtëdhjetat, kurse unë përgjysmë më i ri se ai.

Pas përshtypjes me shtrengim

duarsh dhe pas buzëqeshjeve të ndërsjella të çastit, u ulëm në kolltukë përballë njëri-tjetrit. Kur unë e nxora kasetofonin, kërkoi t'i shihte pyetjet. Ia dhashë listën me shumicën e përpiluar nga Blerimi. Steiner e nxori lapsin dhe filloi t'u binte vi disa pyetjeve. "Këtë nuk e di kush është", thoshte për ndonjë filozof, apo "kjo është e parëndësishme" shtonte teksa i anuloi nja 30 për qind të pyetjeve.

Unë u habita pak nga tekanjoret e tij, por nuk e pashë të arsyeshme të reagoja pasi kisha dëshirë që intervista të zhvillohej nën kushtet e ndjenjës së mirë.

Biseda më e rëndësishme u zhvillua pas intervistës. Pasi e futa kasetofonin në çantë, Steiner tha: "Tashti do të pimë çaj". Kur asistentja e tij i solli xhygmat e porcelanit, më dhe pyeti: "A pini ju shqiptarët çaj?"

"Aty, ku jetoj unë, pihet çaji me të madhe", ishte përgjigja ime.

"Ku jeton ti?"

I fola për Gjilanin dhe Kosovën.

"Natyrisht, vetëm popujt që kanë jetuar në perandori e dinë kënaqësinë e çajit", tha ai.

E, kështu, në mënyrë të ngadalshme, por të këndshme, filloi muhabeti që po dilte më interesant se intervista.

Për luftën që ende zhvillohej në Jugosllavi, Steiner mundohej të mbante qëndrim neutral. Tentonte t'i fajësonte njësoj të gjitha palët në konflikt. Nuk e fajësonte vetëm Serbinë, siç bënin shumë intelektualë gjatë asaj kohe. Ballkani për te

dukej se ishte arenë e njerëzve të egër.

Gjatë bisedës doli se Steiner ishte më tekanjor dhe më nervoz se që prezantohej. Ishte i mendimit se hebrenjtë i kanë dhënë botës më shumë civilizim se myslimanët dhe të krishterët së bashku, për të cilën gjë unë i dhashë shenja mospajtimi. Se ai ishte hebre, dihej.

"Numri i nobelistëve hebrenj është enorm", tha ai duke e forcuar argumentin e tij për të treguar shifrën tejet të madhe të nobelistëve të përkatësisë së tij nacionale apo etnike.

Gjatë bisedës shtoi se edhe numri i pretenduesve hebrenj është tejet i madh dhe këtë ai e dinte se ishte anëtar i një ekipi që herë pas here këshillohej nga Komiteti i Nobelit. Me fjalë tjera, ai i lexonte veprat e shumë kandidatëve për Nobel.

Ky fakt ishte rast për mua që ta parashtroja atë pyetjen që e bënë çdo shqiptar: Kur do ta merr Ismail Kadare Çmimin Nobel?

"Kurrë, hiq", më tha.

"Pse?"

Më tha se ia kishte lexuar disa romane të cilat në fakt nuk e arrinin nivelin e shpërblimit në fjalë. "Megjithatë, ka gjasë", më tha dhe vazhdoi.

Kadare, sipas Steinerit, duhej t'i plotësonte dy kushte në veprat e tija që t'i afrohej seriozisht shpërblimit në fjalë. Kushti i parë: Kadare duhej të shpjegonte pse në Ballkan ka aq shumë prirje apo etje për dhunë dhe,

kushti i dytë, Kadare duhej ta kuptonte lëvizjen e civilizimit që është bërë në botë dhe peshën e tij dhe ndikimin e ndërsjellët që ka treguar deri tani.

Kushti i dytë ishte i paqartë apo "ambivalent", siç i thashë, por ky i pari nuk do të duhej të ishte problem. Kushtin e parë nuk e plotësonin gjithë ata hebrenj, pasi që nuk e kishin shpjeguar apo nuk kishin kontribuar as ata në ndalimin e dhunës në mes hebrenjve dhe palestinezëve në Izrael dhe Palestinë.

Ky mendim i imi e acaroi bisedën, pasi që Steiner nuk kishte përgjigje dhe e mbronte pozitën e shtetit izraelit. Megjithatë, Steiner më doli mjaft kontrovers pasi që në bisedë tashti fliste ndryshe nga intervista.

la bëra me dije se nuk isha ndonjë ithtar i Kadaresë, por kushtet e paraqitura nuk dilnin nga ndonjë kriter valid. Tekefundit, kishte plot që kishin marrë Nobelin e nuk kishin treguar ndonjë vlerë që e kërkonte ai. "Mos u lodh", më tha, dhe shtoi: "Nuk e merr dot".

Ka kohë që Steiner me siguri nuk këshillohet për Nobel. As kushtet e tija nuk duhet më të jenë në fuqi. Ai tash është në pension dhe në pleqëri të thellë, sikur edhe Kadareja. Megjithatë, kushtin e dytë, nëse ekziston ende, Kadare nuk e plotëson kurrë.

Për fund, më duhet ta pranoj se Steiner ishte mjeshtër edhe për përgatitjen e çajit dhe se që të dy e preferonim të njëjtin lloj: Earl Grey.

/Telegrafi/

Integra: Anëtarët e ASHAK-ut janë njerëzit më të paguar në regjion

Raporti “Instituti i vetizoluar (vlersëim i shoqërisë civile për institutin albanologjik të Prishtinës)”, u prezantua para medieeve në ambientet e hotelit “Sirius”, ku nëpërmjet 20 gjetjeve u shpërfaqën ngecjet dhe u dhanë rekomandimet për këto gjetje



Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës dhe Instituti Albanologjik janë dy institucione relevante të shoqërisë tonë. Por, përgjatë viteve në këto dy institucione ka pasur mjaft probleme, me të cilat këto dy institucione përballen sot e kësaj dite.

Organizata “Integra” që mëton mëkëmbjen dhe zhvillimin e Kosovës dhe të rajonit, prezantoi këtë raport 1-vjeçar të autorit Shkëlzen Gashi që hyn në kuadër të projektit “Rishikim i shoqërisë civile dhe dialog publik për institucionet e heshtura të Kosovës të financuara nga fondet publike”, projekt ky që ka për qëllim të reflektojë mbi punën e institucioneve specifike publike të Kosovës.

Botuesi i këtij raporti Kushtrim Koliqi në fjalën hyrëse foli në pika të shkurtra për projektin, të cilin ai e cilësoi si shumë të rëndësishëm.

“Para se të fillojmë të iniciojmë projekte të tilla, në diskutim e sipër me shoqëritë civile e kemi parë se shumë institucione të cilat funksionojnë si ishull, nuk i japin askujt llogari, nuk dihet shumë për ta, aktiviteti i tyre

është shumë i izoluar” tha Koliqi në fillim.

“Kur kemi nisur t’i listojmë këto institucione, ka dalë një numër i madh i tyre që marrin para publike por nuk dihet shumë për to, nuk dihet as llogaridhënia e as çka bëhet realisht në to. Ne kemi bërë një vlerësim të tillë për Akademinë e Shkencave të Kosovës pasi që kemi realizuar një aktivitet, pastaj kemi vazhduar me Institutin Albanologjik. Projekti si i tillë, synon të iniciojë dialog më të gjerë në publik rreth këtyre institucioneve, të cilat besojmë që nuk bëjnë mjaftueshëm për të qenë të hapur ndaj publikut për punën e tyre”, ka thënë Koliqi.

Duke folur për qëllimin e këtij projekti, Koliqi u shpreh se qëllimi i këtij projekti është që të rishikojë dhe vlerësojë punën e institucioneve publike të Kosovës të cilat financohen prej parasë publike.

“Konkretisht, ne merremi me strukturën e brendshme, funksionimin, publikimet dhe rezultatet e këtyre institucioneve. Në fund ne japim rekomandime se si

këto institucione ta përmirësojnë performancën e tyre, gjithmonë në linjë të transparencës dhe llogaridhënies”, përfundoi Koliqi. Tutje, para gazetarëve autori i këtij raporti që specifikisht merret me këto dy institucione relevante Shkëlzen Gashi e prezantoi atë në tërësi. Si i tillë, raporti përmban 20 gjetje që janë bërë pas hulumtimeve dhe intervistave me personat relevantë përgjatë periudhës 1-vjeçare.

Duke treguar ngecjet e këtyre institucioneve, jepen gjithashtu rekomandimet që ta përmirësojnë performancën.

“Anëtarët e Akademisë së Arteve dhe Shkencave të Kosovës janë njerëzit më të paguar në regjion. Ata marrin paga nga 1250 përkatësisht 1500 euro për dallim prej kolegëve të tyre që i marrin trefish më pak. Gjendja bëhet edhe më rëndë sepse ata nuk

punojnë shumë”, tha ai në fillim të prezantimit.

“Nëpër tryezat, simpoziumet e konferencat që organizohen nuk e kemi të pranishme as gjuhën angleze dhe as serbe, që janë gjuhë zyrtare. Megjithëse me buxhet mbi gjysmë milioni eruo, janë vetëm dy projekte të mëdha, vepra shkencore e Rexhep Qosjes, dhe vepra shkencore e Anton Çettës që s’ka përfunduar ende”, potencoi ai.

“Rekomandimi është ky, duhet të sqarohet cila është vlera shkencore e veprës së Qosjes dhe Çettës dhe jo e të tjerëve, pse është e nevojshme të botohen veprat e këtyre dy ish-punonjësve të Institutit. Qosja sepse konsiderohet si babai i kombit dhe se ka dhënë kontribut të madh në çështjen kombëtare dhe përpjekjen e shqiptarëve për pavarësi, apo Anton Çetta me pajtimin e

gjaqeve tek shqiptarët në një periudhë të rëndë. Cila është vlera shkencore e këtyre dy personaliteteve të rëndësishme, më shumë politike sesa shkencore” erdhi në konkludim Gashi.

Në vazhdim të paraqitjes së gjetjeve në kuadër të këtij raporti, Gashi foli për projektet shkencore ku hyjnë librat dhe revistat, të cilat sipas tij kanë mjaft probleme sepse nuk botohen në të gjitha gjuhët zyrtare, pra në gjuhën angleze dhe serbe, e po ashtu botimi ekskluzivisht i autorëve shqiptarë dhe në të njëjtën gjuhë. Po ashtu u përmend mos përditësimi i faqeve zyrtare të institucioneve dhe mos shfaqja e CV-ve të punëtorëve institucional.

Ky botim është realizuar me përkrahjen e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). /Kultplus

Franz Kafka, letra për Felice Bauer



Fräulein Felice!

Tani do të të kërkoj një favor që tingëllon pak si i çmendur, të cilin do ta përshëndes kur të marr unë letër. Është gjithashtu testi më i madh në të cilin mund të vihet njeriu më i mirë.

Mirë, ja ku është:

Më shkruaj vetëm njëherë në javë, kështu që letrat e tua të më vijnë ditën e diel, sepse nuk mund t’u rezistoj letrave të tua të përditshme. Për shembull, unë i përgjigjem një nga letrat e tua, dhe pastaj shtrihem në krevat në dukje i qetë, por zemra ime rreh përmas gjithë trupit vetëm prej teje. Unë të përkas ty. Nuk ka asnjë mënyrë tjetër për ta shprehur këtë, dhe kjo nuk është mënyra më e mirë. Po për këtë arsye nuk dua të di se çfarë vesh. Më ngatëron aq shumë, saqë s’mund të merrem me jetën. Nuk dua ta di që edhe ti ndjen për mua. Po ta dija, si mundja, si budalla që jam, të ulesha në zyrën time, apo këtu në shtëpi,

në vend që të hipja në një tren me sytë që hapen dhe mbyllen vetëm kur jam me ty? Oh, ka një arsye të trishtueshme, që nuk s’e bëj dot këtë. Për t’i rënë shkurt: Shëndeti im është i mirë vetëm për të përballuar veten time. Ai s’është i mjaftueshëm për martesë, duke lënë mënjane të bërit baba. Sidoqoftë, kur lexoj letrat e tua, ndjej se mund të lartësohem edhe mbi atë që nuk mund të lartësohet.

Ah sikur ta kisha përgjigjen tënde tani. Dhe sa keq të torturoj, dhe sa të detyroj ty në qetësinë e dhomës tënde të lexosh këtë letër, si letra më e ulët që është vënë ndonjëherë në tryezën tënde.

Ndershmërisht, ndjehem keq ndonjëherë kur lutem si një luga mbi emrin tënd lumturues! Ah sikur ta kisha postuar letrën e së dielës, në të cilën të kisha kërkuar të mos më shkruaje më kurrë, dhe në të cilën të jepja një premtim të ngjashëm. Oh Zot, çfarë më ndaloi të ta dërgoja këtë letër? Çdo gjë do ishte në

rregull. Por a është kjo zgjidhje e paqte e mundur tani? Çfarë do të ndihmonte nëse ne do i shkruanim njëri-tjetrit vetëm një herë në javë? Jo, sikur vuajtja ime të kurohej nga mjetet të tilla, atëherë ajo s’do ishte serioze. Dhe tashmë parashikoj që s’mund të jem në gjendje t’iu rezistoj as letrave të së dielës. Kështu, për të kompensuar mundësinë e humbur të së dielës, të kërkoj me gjithë fuqinë që më ka mbetur në fund të kësaj letre: Nëse i vlerësojmë jetët tona, le të mos shkruajmë më. Mos po mendoja të nënshkruaja me Dein? Jo, s’do të kishte gjë më false se sa kjo. Jo, unë jam gjithmonë i lidhur me zinxhirë me veten time. Ky jam unë, dhe kjo është ajo me të cilën duhet të jetoj.

11 nëntor, 1912

(Kafka e takoi për herë të parë Felice Bauer në vitin 1912. Për pesë vjet ata patën një histori dashurie). /Kultplus

Atwood për feminizmin dhe keqkuptimet

Romancierja kanadeze Margaret Atwood, që ka marrë etiketën e feministes për temat që ka trajtuar në veprat e saj, ka thënë se feminizmi nuk duhet të supozojë se gratë kanë gjithmonë të drejtë, pavarësisht kontekstit.

Sipas saj, një grup i feministeve mendojnë se gratë gjithmonë janë "më të mira" se meshkujt. Gjatë një interviste, ajo pyetët për këtë dhe nëse është mërzi-tur nga pyetjet nëse vepra e saj, "Rrëfenja e shërbëtores", është libër feminist,

"Nuk mërzitem për këtë, por duhet të kuptojmë se është bërë një nga ato çështjet që mund të nënkupton gjëra tjera", përgjigjet ajo. "Siç e them zakonisht: 'Më trego çfarë nënkupton me atë fjalë dhe pastaj mund të bisedojmë'. Nëse njerëzit nuk më tregojnë se çka mendojnë, atëherë nuk kanë ide se për çfarë po flasim. Pra, a i nënkuptojmë të drejtat ligjore? A janë gratë më të mira

se meshkujt? A duhet të gjithë meshkujt të hidhen nga shkëmbi? Çka mendojmë? Sepse, të gjitha këto fjalë kanë kuptime të ndryshme".

Në kohën e demonstratave kundër Presidentit Trump, ajo u shndërrua në ikonë të lëvizjes së grave. Por, kur e pyetën nëse e konsideron veten të tillë, ajo përgjigjet: "Çfarë do të thotë kjo? Nëse të jesh feministe do të thotë që gratë janë qenie njerëzore, atëherë po unë jam feministe. Nëse kjo fjalë do të thotë se gratë janë engjëj, një lloj perfekcioni, jo, të gjithë e dimë se nuk është e vërtetë".

Në një shkrim ajo madje ka thënë se cilësohet "Feministe e keqe". Aty ndër të tjera ka shkruar: "Gratë janë qenie njerëzore, me gjithë gamën e sjelljeve të shenjta dhe demonike që ajo përfaqëson, përfshirë ato kriminale. Ato nuk janë engjëj e të paafta për të bërë keq. Po të ishin engjëj, nuk do të na duhej sistemi ligjor".



Të burgosurit shfaqin punimet e tyre



Në ndërtesën e Qeverisë, ish-Pallati i Rilindjes, për nder të shënimit të 20-vjetorit të themelimit të Shërbimit Korrektues të Kosovës, është hapur një ekspozitë me punimet artistike dhe artizanale të të burgosurve.

Paraprakisht ekspozita ishte hapur në Shtëpinë e Kulturës "Adem Jashari" në Istog, në Qendrën e Kulturës "Tahir Sinani" në Lipjan, për të përfunduar në Prishtinë.

Në këto ekspozita u prezantuan punimet në të cilat personat e burgosur shprehin botën e tyre

të brendshme apo edhe pendimin në lidhje me atë që ka ndodhur. Punimet paraqesin qartë se ata mendojnë dhe sillen ndryshe, si dhe se janë të përgatitur për riintegrim.

Shërbimi Korrektues i Kosovës mbetet i përkushtuar që të luajë rolin e vet për t'i ndihmuar të burgosurit që të ndryshojnë pozitivisht dhe të përgatiten për riintegrim në shoqëri, si individë të përgjegjshëm dhe të dobishëm për shoqërinë dhe rrethin ku do të jetojnë.

Një muze dedikuar Sterjo Spasses

Shtëpia e shkrimtarit Sterjo Spasse në Gollomboç të Bashkisë së Pustecit, së shpejti do të kthehet në muze. Investimi është financuar nga Bashkimi Evropian me vlerë 200 mijë euro, në kuadër të projekteve ndërkuftare.

Drejtori i trashëgimisë kulturore ne qarkun e Korçës, Gjergji Kokim shprehet se muzealizimi i shtëpisë së Sterjo Spasses do të jetë një vlerë e shtuar për fshatin

Gollomboç, por edhe për të gjithë bashkinë e Pustecit.

Koki tregon se objekti ku dikur ka banuar shkrimtari Sterjo Spasse sot është në një gjendje të degraduar.

Projekti do të ketë një kohëzgjatje prej dy vjetësh. Me përfundimin e rikonstruksionit shtëpia e shkrimtarit do të pajiset edhe me objekte të cilat janë përdorur prej tij apo edhe me dorëshkrime dhe dokumente. /Vizion Plus/






EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Ku do të ndërtohet stadiumi kombëtar, në Drenas apo Prishtinë?

Pavarësisht se është marrë vendimi që stadiumi kombëtar të ndërtohet në Drenas, ai mund të mos ndërtohet aty ku është thënë, por të zhvendoset në Prishtinë. Federata e Futbollit e Kosovës është neutrale lidhur me këtë çështje. "Është projekt i Qeverisë së Kosovës dhe ne nuk kemi asnjë ndikim aty. Dëshira jonë është që të ndërtohet sa më shpejt që është e mundur. Nëse është e nevojshme, jemi të gatshëm të kontribuojmë me një ekip profesional", ka thënë Ademi



pasur nevojë për shpronësim dhe kështu e ka ulur ndjeshëm koston e projektit", thuhet në njoftimin e kësaj ministrie.

MKRS-ja, po ashtu, ka përmendur edhe fakte të tjera të cilat kanë qenë të arsyeshme që stadiumi të ndërtohet në Drenas. "Afërsia me Aeroportin Ndërkombëtar 'Adem Jashari' dhe qasja në autostradën 'Ibrahim Rugova'. Në vendimmarrje jemi bazuar edhe te qëndrimi i trajtimit të barabartë për të gjitha skajet e territorit të Kosovës që stadiumi të ndërtohet në qendër të Republikës së Kosovës", thuhet në njoftimin e MKRS-së.

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Qeveria Haradinaj, me propozim të ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, një vit më parë pati marrë vendim që stadiumi kombëtar i Kosovës të ndërtohet në Korreticë të Drenasit dhe jo në Bërrnicë të Prishtinës. Mirëpo vendimi i qeverisë Haradinaj mund të mos jetësohet pasi me ndërrimin e pushtetit, pas zgjedhjeve të parakohshme të 6 tetorit, mund të ndryshojë edhe lokacioni i stadiumit.

Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka paralajmëruar se stadiumi kombëtar nuk do të ndërtohet në Drenas, por në Bërrnicë. Ai ka bërë me dije se për një gjë të tillë tashmë janë pajtuar partia e tij dhe Lëvizja Vetëvendosje, të cilat janë duke punuar për ndërtimin e qeverisë së re. "Gjatë bisedave kemi vendosur që stadiumi i Kombëtares së Kosovës të ndërtohet në Bërrnicë dhe jo në Drenas", ka thënë Abdixhiku.

Redaksia e sportit e gazetës "Epoka e re" e ka kontaktuar edhe kryetarin e Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, lidhur me këtë çështje. Ai ka thënë se kjo është një çështje që i takon Qeverisë së Kosovës dhe se FFK-ja nuk ka qasje në vendimmarrje. "Është projekt i Qeverisë së Kosovës. Ne nuk kemi asnjë ndikim aty. Dëshira jonë është që ndërtohet sa më shpejt që është e mundur. Normalisht se jemi të gatshëm, nëse është e nevojshme, të kontribuojmë me një ekip profesional", ka thënë Ademi.

I pyetur nëse qeveria e re do ta kërkonte mendimin e Komitetit Ekzekutiv të Federatës së Futbollit lidhur me lokacionin e stadiumit, Ademi nuk ka dhënë ndonjë mendim, përpos që ka kërkuar që ky stadium të ndërtohet sa më shpejt që është e mundur dhe se Federatës i duhet në cilindo vend që ndërtohet. "Me rëndësi është që ky stadium të ndërtohet sa më shpejt sepse Kosova ka nevojë për një stadium të tillë. Po shihet çfarë po ndodh me bileta dhe me kërkesat e qytetarëve që t'i përcjellin ndeshjet e përfaqësueses. Ne si federatë kërkojmë që stadiumi të ndërtohet sa më shpejt në Kosovë. Nuk kemi stadium nacional dhe në rast se nuk mund t'i zhvillojmë ndeshjet në stadiumin 'Fadil Vokrri', atëherë si alternativë e kemi stadiumin në Shkodër derisa të ndërtohet stadiumi ynë", ka deklaruar Ademi, i cili nuk e di se kur pritet të fillojnë punimet për ndërtimin e stadiumit kombëtar.

Për "Epokën e re", lidhur me çështjen e stadiumit, ka folur edhe trajneri me përvojë të madhe në futbollin e Kosovës, Gani Sejdiu. Ky i fundit mendon se vendimet dhe debatet lidhur me çështjen e stadiumit janë politike. "Nuk është mirë të kemi këto debate sepse është një projekt sportiv por, për fat të keq, po përdoret nga politika. Nëse i shikojmë vendimet apo debatet, shohim se janë për interesa politike dhe kjo nuk është mirë, sepse jemi një vend i vogël dhe duhet t'u gëzohemi sukseseve të përfaqësueses dhe jo të krijojmë ndarje të regjioneve", ka thënë Sejdiu, i cili ka një ide interesante lidhur me stadiumin.

Ai beson se shumë më mirë do të ishte që të investohet në stadiumet e tjera. "Mendoj se është dashur të investojmë në stadiumin 'Fadil Vokrri', që ta shtojmë kapacitetin edhe në stadiumin 'Adem Jashari', kurse disa mjete të tjera t'i investojmë nëpër stadiumet e Superligës, ku gjenda e tyre nuk është e mirë dhe, të them të drejtën, nuk i intereson akujt. Megjithatë, projekti për stadiumin nacional është madhor dhe do t'i shërbejë Kosovës për të ardhmen, por nuk është mirë të përdoret për interesa politike", ka deklaruar Sejdiu.

Kundër ndryshimit për ndërrimin e lokacionit ka dalë kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, i cili ia ka rikujtuar anëtarit të kryesisë së LDK-së, Lumir Abdixhiku, atë që ia kishte kërkuar edhe kandidatet për kryeministër në zgjedhjet e fundit nga radhët e LDK-së, Vjosa Osmani, që mos të kërkohej ndryshimi i lokacionit. "Gjatë fushatës e kam dhënë një mesazh rreth stadiumit nacional, për mbesën tonë: Mos e vokë atë ujë. Njëjtë i them edhe deputetit Abdixhiku: Mos e vokë atë ujë! Shpresoj se ky vend ka mendje të kthjellëta dhe mendojnë mirë kah po e çojnë vendin", ka deklaruar Lladrovci.

MKRS-ja kundër ndryshimit të lokacionit për ndërtimin e stadiumit kombëtar

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka reaguar duke kundërshtuar ndryshimin e lokacionit të ndërtimit të stadiumit nacional,

pasi ka vlerësuar se çdo ndryshim e rritë koston e stadiumit dhe e komplikon situatën. "Vlerësojmë se ndryshimi eventual i lokacionit do ta rriste koston e stadiumit, do ta komplikonte situatën edhe më tej dhe është një tendencë e qartë për ngecjen e këtij projekti, për më shumë janë lajme dëshpëruese për qytetarët e Republikës së Kosovës në një kohë kur vendit tonë i duhet më së shumti ky projekt i cili është i gatshëm për të filluar", thuhet në njoftimin e MKRS-së.

Më pas Ministria e Sportit ka sqaruar se pse është më mirë që stadiumi kombëtar të ndërtohet në Drenas. "MKRS-ja fillimisht ka planifikuar që stadiumin kombëtar të Kosovës ta ndërtojë në Prishtinë. Kemi analizuar hapësirën në fshatin Bërrnicë, e cila ka rezultuar me konteste pronësore, ka pasur hapësira që është dashur të shpronësohen dhe kjo e ka rritur koston e tërësishme të projektit. Për më keq, ish-qeveria Mustafa nuk kishte zhvilluar asnjë procedurë për ndërtimin e stadiumit në Bërrnicë. Ndërkaq, lokacioni i tanishëm, për të cilin është marrë vendim që të ndërtohet stadiumi, ka qenë më i favorshmi për arsye të shumta. Dallimi në kilometra nga Prishtina në Korreticë ose Bërrnicë është vetëm 5 km. Gatishmëria dhe bashkëpunimi i Komunës së Drenasit për ta ofruar një hapësirë të këfillë, ku tashmë prona ka kaluar të gjitha procedurat e duhura, duke qenë e dedikuar për stadium. Hapësira e tanishme, konkretisht ngastrat e kadastrave të ndara për stadiumin kombëtar, kanë qenë pronë e cila nuk ka



Besim Halilaj merr titullin 'Doktor i shkencave sportive'

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Besim Halilaj ka mbrojtur tezën e doktoratës në Fakultetin e Kulturës Fizike në Universitetin Shtetëror të Malit të Zi dhe me këtë rast ka marrë titullin "Doktor i shkencave sportive". Halilaj, përpos që është ligjërues në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe të Sporteve (FEFS), është edhe kryetar i Federatës së Gjymnastikës së Kosovës. Njoftimin për mbrojtjen e temës së doktoratës të dr. Besim Halilaj e ka bërë sekretari i përgjithshëm i Federatës së Gjymnastikës së Kosovës, Amir Tahiraga në faqen zyrtare të FGJK-së. "Më datë 19/11/2019, FGJK-së iu shtua edhe një doktor shkence. I urojmë kryetarit të FGJK-së, z. Besim Halilaj, mbrojtjen e titullit "Doktor shkence në sport". Urime dhe suksese!", thuhet në njoftimin e FGJK-së.

Peja kërkon fitoren e tretë në Ligën Ballkanike

PEJE, 20 NËNTOR - KB Peja e ka nisur shumë mirë këtë edicion në Ligën Ballkanike, duke shënuar dy fitore në dy ndeshjet e para. Pejanët sonte

(e enjte) do të ballafaqohen me skuadrën bullgare Academic Bultex 99. Takimi zhvillohet në palestrën 'Karagaçi' me fillim nga ora

19:00. "Verdhezinjtë" në ndeshjen e parë kishin fituar ndaj Rahovecit, kurse në të dytën ndaj Vllaznisë. Të enjten kërkojnë fitoren e tretë radhazi

në këtë edicion në BIBL. Edhe skuadra bullgare ka shënuar dy fitore në dy ndeshje, andaj ballafaqimi i sotëm do të jetë shumë interesant.



Pandev: Kosova është reprezentacion cilësor, por ne kualifikohemi

SHKUP, 20 NËNTOR - Kosova në mars do të takohet me Maqedoninë Veriore në kuadër të gjysmëfinale në Ligën e Kombeve. Kapiteni i Maqedonisë Veriore, Goran Pandev, ka shprehur optimizëm se skuadra e tij do ta

arrijë kualifikimin në Kampionatin Evropian. "Në mars na pret Liga e Kombeve dhe shpresoj që përmes kësaj gare do ta gëzojmë Maqedoninë dhe të kualifikohemi në 'Euro 2020'. Kjo gjeneratë meriton

të luajë në ngjarje të madhe. Deri në mars kemi kohë. Me rëndësi është të jemi të gatshëm dhe të kompletuar për ato gara. E di se do të kemi mbështetje të madhe nga publiku, kurse nga ne varet gjithçka. Kemi mundësi të

shkëlqyeshme të fitojmë, megjithatë në futboll gjithçka mund të ndodhë. Edhe Kosova ka reprezentacion cilësor. Megjithatë, shpresoj se do të kualifikohemi në Evropian", ka thënë Pandevi.



Vëllazërorja Shqipëri - Kosovë, në Ditën e Flamurit

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Për nder të Ditës së Flamurit, më 28 Nëntor, do të zhvillohet miqësorja ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës në basketboll. Ndeshja do të zhvillohet në Shkodër, të enjten nga ora 17:00. Kosovën në këtë ndeshje do ta udhëheqë Bujar Loci, kurse ekipi do të përbëhet nga lojtarët e Superligës.

Shqipëria dhe Kosova gjithmonë kanë pasur bashkëpunim të mirë dhe kanë zhvilluar ndeshje miqësore për festat kombëtare dhe shtetërore. Drejtori i Përfaqësueses së Kosovës, Granit Rugova, ka thënë se bashkëpunimi ndërmjet dy federatave është i mirë dhe kjo dëshmon edhe me zhvillimin e kësaj miqësore vëllazërore. "Ne kemi pranuar me kënaqësi ftesën nga Federata Shqiptare e Basketbollit të zhvillojmë këtë ndeshje vëllazërore. Rezultati është në plan të dytë. Ne gjithmonë kemi pasur bashkëpunim të mirë me Federatën Shqiptare dhe ky bashkëpunim do të thellohet edhe më shumë. Për shkak të orarit, ekipi i Kosovës do të përbëhet nga lojtarët e Superligës, kurse ndeshjen do ta udhëheqë trajneri Bujar Loci", është shprehur Rugova për faqen zyrtare të FBK-së.

Kosova dhe Shqipëria kanë zhvilluar shumë ndeshje miqësore ndërmjet tyre. Së fundi u përballën në korrik të



këtij viti në Prishtinë, ku në të dyja ndeshjet fituan "dardanët". Ndërkohë, në pranverën e vitit të ardhshëm do të organizohet një turne në Kosovë, me katër skuadrat më të mira të Kosovës të meshkujt dhe katër më të mirat të Shqipërisë, kurse në vjeshtën e ardhshme do të

organizohet edhe një turne tjetër, me dy skuadrat më të mira të Kosovës dhe dy më të mirat nga Shqipëria. Ky projekt do të jetë në kuadër të thellimit të bashkëpunimit ndërmjet Federatës së Basketbollit të Kosovës dhe Federatës Shqiptare të Basketbollit.

Lakersat, 'leksion' edhe Oklahomës

LOS ANGELES, 20 NËNTOR - Viojnë paraqitjet e mira të ekipit të Lakersit në NBA, që e mposhti me rezultat 112-107 Oklahomën. Ndeshje e dominuar nga skuadra kaliforniane, që kishte një epërsi të vogël gjatë gjithë kohës, duke e merituar fitoren. Davis ishte shënuesi më i mirë, me 34 pikë, por një paraqitje të shkëlqyer bëri sërish LeBron James, që realizoi një "triple-double", me 25 pikë, 11 rebounde e 10 asistime. Fitoren e tretë sezonale e regjistroi Golden State, që mposhti me rezultat 114-95 Memphisin jashtë fushe. Mysafirët dominuan në ndeshje, me Burksin që realizoi 29 pikë. Fiton edhe skuadra e



New Orleansit që, falë 22 pikëve të Holidayt dhe 21 të Ingramit, mundi 115-104 Portlandin. Ndërsa ekipi i

Sacramentos triumfoi 120-116 ndaj Phoenixit, me Bogdanoviçin që shkëlqeu në fushë, autor i 31 pikëve.

REZULTATET

Memphis - Golden State	95-114
New Orleans - Portland	115-104
Sacramento - Phoenix	120-116
Lakers - Oklahoma	112-107

SHKURT

Ismajli në 'radar' të dy klubeve italiane

Futbollisti i Kombëtares së Shqipërisë, Ardian Ismajli, mund të transferohet në Serinë A. Mediat në Kroaci raportojnë se futbollisti nga Kosova ka tërhequr vëmendjen e Atalantës dhe Bolognas. Ai ka kontratë me skuadrën e Hajdukut të Splitit deri në vitin 2022, por kjo nuk do të thotë se nuk do të transferohet në kampionatin elitë të Italisë. 23-vjeçari karrierën e ka nisur në skuadrën e 2 Korrikut, kurse më pas luajti edhe për Prishtinën.

Mourinho i entuziazmuar që emërohet trajner i Tottenhamit

Jose Mourinho, pas marrjes së detyrës së trajnerit të klubit anglez Tottenham Hotspur, ka thënë se është i entuziazmuar që i bashkohet një klubi me një trashëgimi kaq të madhe. Mourinho e zëvendëson trajnerin e shkarkuar Mauricio Pochettino. "Jam i entuziazmuar që bashkohem me një klub me një trashëgimi kaq të madhe dhe mbështetës të tillë pasionues. Cilësia si në skuadër ashtu edhe në akademi më emocionon. Puna me këta lojtarë është ajo që më ka tërhequr", ka thënë Mourinho, i cili është një nga menaxherët më të trofeshëm në botë, pasi që ka fituar 25 trofe të mëdhenj gjatë kohës së tij te Porto, Interi, Chelsea, Real Madridi dhe Manchester Unitedi.

Skriniari ka të ardhme në Spanjë

E ardhmja e Milan Skrinari duket të jetë larg Interit, pasi sllovaku mund të transferohet në Spanjë ku ofertat nuk mungojnë nga Real Madridi dhe Barcelona. "Barcelona dhe Reali i Madridit duelojnë prej kohësh për ta marrë Milan Skrinari por, sipas informacioneve që kam, negociatat kanë avancuar me 'Los Blancos', që pritet ta marrin mbrojtësin në verë", ka thënë Mithat Halis, ish-menaxher i Milan Skrinari.

Pulisiqi mungon kudër Cityt

Mesfushori Chrisian Pulisiq pritet të mungojë ndaj Manchester Cityt për shkak se po vuan nga një lëndim në nyjë. Pulisiq është rikthyer në formën e duhur, pasi në fillim të sezonit kishte shumë kritika ngaqë nuk arrinte t'i tregonte tërë kualitetet. Tjetër lojtar që do të mungojë është Ross Barkley, i cili ka munguar edhe ndaj Crystal Palace.

Rusia rrezikon përjashtimin edhe nga 'Tokio 2020'

Pas pezullimit nga Olimpiada e Rios tri vjet më parë (2016), Rusia mund të përjashtohet edhe në Lojërat Olimpikë "Tokio 2020" që zhvillohen vitin e ardhshëm. Sipas së përditshmes britanike "The Independent", komiteti ekzekutiv i antidopingut botëror (WADA) do të zhvillojë një takim më 9 dhjetor, ku pritet të miratohet një rezolutë kundër Rusisë. Më konkretisht, WADA do t'i rekomandojë Komitetit Olimpik Ndërkombëtar faktin se antidopingu rus ende nuk po bashkëpunon me të, pas skandalit doping që pushtoi këtë vend. WADA kërkon t'i zbulojë materialet e fshehura nga antidopingu rus (Rusada) në lidhje me testet e kryera prej saj me sportistët rusë në periudhën janar 2015-gusht 2016.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



DREJTORIA E ARSIMIT
05NR.1082 Datë:19.11.2019

Në bazë të nenit 5 të Rregullores për ndarjen e bursave për nxënës dhe studente të Komunës së Suharekës 01-Nr-016-7790 të datës 31.01.2019, Drejtoria Komonale e Arsimit në Suharekë në bazë të vendimit të Kryetarit të Komunës 01nr.016-75708 të datës 13.11.2019, shpall kërë:

KONKURS

Për ndarjen e bursave për nxënës dhe studentë për vitin shkollor 2019/2020

Drejtoria e Arsimit për vitin shkollor 2019/2020, shpall konkurs për 210 bursa (130 bursa për studentë dhe 80 bursa për nxënës të shkollave të mesme të larta). Bursat ndahen vetëm për studentë dhe nxënës që janë banorë të përhershëm të Komunës së Suharekës dhe që i vijojnë mësimet/studimet themelore në shkollat përkatësisht Universitetet publike të Kosovës.

Vlera e bursës për një vit akademik- shkollor do të jetë:

- Për student/e 50 € në muaj për 10 muaj
- Për nxënës /e 25 € në muaj për 10 muaj

Kushtet dhe kriterët:

- Të ketë të regjistruar vitin shkollor/akademik për të cilin jepet bursa.
- Të mos jetë shfrytëzues/e i ndonjë burse tjetër e cila dëshmohe me vërtetim nga fakulteti ku studion.
- Për kandidatët /et që janë regjistruar për herë të parë në fakultet të kenë dëshminë e suksesit të vitit paraprak (diploma dhe dëftesa e vitit të fundit të shkollës së mesme të lartë)
- Gjendja ekonomike sociale e familjes e cila dëshmohe me vërtetim nga Qendra për punë sociale.

Vlerësimi i kushteve dhe kriterëve:

-Fëmijët e dëshmorëve të cilët janë student dhe nxënës të shkollave të mesme të larta, do të ju ndahet bursa jashtë kriterëve të përcaktuara me këtë rregullore, por të gjithë studentët dhe nxënësit e kësaj kategorije janë të obliguar ta sjellin vërtetimin e regjistrimit të semestrit për vitin akademik të studimeve kur ndahet bursa.

• **Kriteret dhe prioritetet për fitimin e së drejtës në bursë janë si më poshtë:**

1. Nota mesatare 9 deri në 10,00, në fakultete, vlerësohet me 20 pikë,
2. Nota mesatare 8 deri në 8,99 në fakultete, vlerësohet me 15 pikë,
3. Nota mesatare 7 deri në 7,99 në fakultete, vlerësohet me 10 pikë,
4. Nota mesatare 6 deri në 6,99 në fakultet, vlerësohet me 5 pikë,
5. Suksesi i shkëlqyeshëm 4,5 deri në 5 në shkollat e mesme të larta vlerësohet me 20 pikë,
6. Suksesi shumë mirë 3,5 deri në 4,49 në shkollat e mesme vlerësohet me 15 pikë,
7. Suksesi i mirë 2,5 deri në 3,49 në shkollën e mesme vlerësohet me 10 pikë,
8. Për familjet që kanë 2 (dy) student nga e njëjta familje 10 pikë,
9. Për familjet që kanë tre student (vëllezër - motra) nga e njëjta familje i shtohen edhe 5 pikë të tjera.
10. Për kandidatët e SHML që kanë dy nxënës nga e njëjta familje vlerësohen me 10 pikë.
11. Për familjet që kanë tre (3) nxënës në shkollat e mesme të larta (SHML), (vëllezër -motra) nga e njëjta familje i shtohen edhe 5 pikë.
12. Pikët e studentëve janë të vlefshme vetëm për kategorinë e studentëve dhe pikët e nxënësve
13. Gjendja ekonomike- financiare (rastet sociale) vlerësohen me 30 pikë.
14. Studentët/ nxënësit të cilët nuk kanë asnjërin prind në jetë, fitojnë bursën me automatizëm,
15. Fëmijët pa njërin prind vlerësohen me 10 pikë,
16. Fëmijët që i kanë të dy prindërit me aftësi dhe që është vetë me aftësi të kufizuar vlerësohen me 15 pikë.
17. Fëmijët e ish të burgosurve politikë dhe ish të dënuarve politikë, vlerësohen me 8 pikë,
18. Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së, vlerësohen me 12 pikë,
19. Fëmijët të cilët nuk kanë asnjërin prind të punësuar dhe nuk krijojnë te ardhura nga asnjë veprimtari, vlerësohen me 15 pikë. Kjo dëshmohe me vërtetimin e lëshuar nga Enti për punësim.
20. Komisioni ruan të drejtën të hulumtojë dhe vërtetojë gjendjen e vërtetë ekonomike-financiar të kandidatit.
21. Fëmijët e viktimave civile të luftës së fundit në Kosovë vlerësohen me 12 pikë,
22. Fëmijët e veteranëve të luftës të UÇK-së vlerësohen me 8 pikë.
23. Nga e njëjta familje mund të përfiton bursa vetëm një student/e dhe nxënës/e, pa marrë parasysh kategorinë e tyre.
24. Nxënësit/et, që kanë poentim të barabartë pas shqyrtimit të aplikacioneve përparësi do të kenë nxënësit/et që kanë distancë më të largët nga institucionet shkollore.
25. Kandidatët me numër të barabartë të pikëve, përparësi do tu jepet atyre me notë mesatare më të lartë gjatë shkollimit të tyre.

Përfitues të bursës nuk mund të jenë këto kategori:

1. Studentët/et dhe nxënësit/et, që kanë dy prind të punësuar në institucionet publike (shtetërore).
2. Studentët/et dhe nxënësit/et, që prindërit e tyre kanë biznes të regjistruar dhe aktiv, e cila dëshmohe me vërtetim nga Qendra e regjistrimit të biznesit.
3. Përfitues i kësaj burse nuk mund të jetë studenti/nxënësi, nëse brenda vitit të njëjtë fiskal ka qenë përfitues i një burse të ndarë nga pushteti qendror ose ndonjë donator tjetër për fushën e arsimit.
4. Nëse vërtetohet se studenti i cili është përfitues i bursës nga komuna, merr bursë edhe nga ndonjë njësi tjetër buxhetore, ai/ajo obligohet ta kthejë bursën.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- ✓ Kërkesa sipas formës së përpiluar nga Drejtoria e arsimit;
- ✓ Vërtetimin se studenti/ja ka regjistruar vitin akademik 2019/20 (origjinale);
- ✓ Certifikata e notave (origjinale);
- ✓ Vërtetimin se studenti nuk është përfitues i bursës universitare;
- ✓ Certifikata mbi vendbanimin e përhershëm;
- ✓ Kopja e letërnjoftimit;
- ✓ Ekstraktin e lindjes;
- ✓ Vërtetim mbi shfrytëzimin e ndihmës sociale për vitin 2019/20;
- ✓ Për studentët e regjistruar në vitin shkollor/akademik 2019/20, kopjet e vërtetuara të dëftesave dhe të diplomës së shkollës paraprake.

Afati i konkurimit është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit të konkursit në mjetet e informimit publik, në faqen zyrtare të Komunës dhe në tabelën e shpalljeve, dokumentet dorëzohen sipas afatit të konkursit dhe nuk pranohet plotësim i dokumentave pas mbylljes së konkursit. Dokumentet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen të kompletuara në Komunën e Suharekës, zyra nr. 1 çdo ditë punë prej orës 8:00 deri më 16:00.

Drejtoria e Arsimit



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



DIREKCIJA ZA OBRAZOVANJE

05 BR .1082 Datum: 18.11.2019

Na osnovu člana 5. Pravilnika o dodeli stipendija za studente opštine Suva Reka 01-Br-016-7790 od 31.01.2019 godine, Opštinska direkcija za obrazovanje u Suvoj Reci na osnovu odluke Predsednika Opštine 01Br.016-75708 od 13.11.2019 godine objavljuje sledeci:

KONKURS

O dodeli stipendija za student i učenike za školsku godinu 2019/2020

Direkcija za obrazovanje za školsku godinu 2019./2020. Objavljuje konkurs za dodelu 210 stipendija (130 stipendija za studente i 80 stipendija za učenike viših srednjih škola).

Stipendije se dodeluju samo studentima i učenicima sa stalnim boravkom u opštini Suva Reka koji pohađaju nastau/osnovne studije u odgovarajućim školama odnosno u javnim univerzitetima Kosova

Vrednost stipendije za akademsku godinu biće:

- 25 € po učeniku u trajanju od 10 meseci
- Studenti 50 € mesečno u trajanju od 10 meseci

Uslovi i kriterijumi:

- Da je upisao školsku / akademsku godinu za stipendije.
- Da ne koristi bilo koju druge stipendiju što će dokazati potvrdom fakulteta u koji studira.
- Kandidati koji su se po prvi put upisali na fakultetu podnose dokaz o uspehu u prethodnu godinu (diploma i svedočanstvo završnog razreda srednje škole)
- Socijalno-ekonomski status porodice potvrđuje Centar za socijalno staranje.

Procena uslova i kriterijuma:

- Deca palih boraca koja su student i učenici srednjih viših škola biće dodeljene stipendije izvan kriterijuma predviđenih ovim pravilnikom, ali svi učenici i studenti ove kategorije dužni da donesu potvrdu o upisu u semestra za akademsku godinu studija kada se stipendija dodjeljuje.

• Kriterijumi i prioriteti za sticanje stipendije su sledeći:

1. Prosečna ocena od 9 do 10,00 na fakultetima se vrednuje sa 20 bodova,
2. Prosečna ocena od 8 do 8,99 na fakultetima se vrednuje sa 15 bodova,
3. Prosečne ocene od 7 do 7,99 na fakultetima, se vrednuje sa 10 bodova,
4. Prosečna ocena od 6 do 6,99 na fakultetu se vrednuje sa 5 bodova.
5. Odlučan uspeh 4,5 do 5 u srednjim školama se vrednuje sa 20 bodova,
6. Veoma dobar uspeh u srednjim školama od 3,5 do 4,59, se vrednuje sa 15 bodova,
7. Dobar uspeh 2,5 do 3,49 u srednjoj školi se vrednuje sa 10 bodova,
8. Za porodice koje imaju 2 (dva) učenika iz iste porodice 10 bodova,
9. Za porodice sa tri učenika (braća i sestre) iz iste porodice, dodaje se još 5 bodova.
10. Za porodice sa tri učenika (braća i sestre) iz iste porodice, dodaje se još 5 bodova.
11. Za kandidate SVŠ sa dva učenika iz iste porodice, dobija se 10 bodova.
12. Za porodice koje imaju tri (3) učenika u srednjim školama (SVŠ), (braća i sestre) iz iste porodice dodaje se 5 bodova.
13. Bodovanja važe samo za kategoriju studenata, a ocene učenika izračunavaju se samo kategoriju učenika iz iste porodice.
14. Ekonomsko-finansijska situacija (socijalni slučajevi) se ocenjuje sa 30 bodova.
15. Studenti / učenici bez oba roditelja, automatski će dobiti stipendiju,
16. Deca bez jednog roditelja vrednuju se sa 10 bodova,
17. Deca koja imaju oba roditelja sa invaliditetom i koja su i sama invalidi vrednuju se sa 15 bodova.
18. Deca bivših političkih zatvorenika i bivših političkih osuđenika ocenjuju se sa 8 bodova,
19. Deca ratnih invalida OVK, vrednuju se sa 12 poena,
20. Deca koja nemaju zaposlene roditelje i ne ostvaruju prihod od bilo koje aktivnosti dobijaju 15 poena. O tome svedoči uverenje izdato od strane Zavoda za zapošljavanje.
21. Komisija zadržava pravo da istraži i proverí istinsko ekonomsko i finansijsko stanje kandidata.
22. Deca civilnih žrtava nedavnog rata na Kosovu vrednuju se sa 12 poena,
23. Deca ratnih veterana OVK vrednuju se sa 8 poena.
24. Samo jedan učenik i jedan student mogu iz iste porodice dobiti stipendiju, bez obzira na njihovu kategoriju.
25. Učenici koji nakon pregledavanja aplikacija imaju jednake ocene imaće prednost što su učenici bili udaljeniji od školskih institucija.
26. Kandidati s jednakim brojem bodova imaće prednost oni sa višim prosečnim ocenama tokom školovanja.

Sledeće kategorije ne mogu biti korisnici stipendije:

1. Studenti i učenici koji imaju dva roditelja zaposlena u javnim (državnim) institucijama.
2. Studenti i učenici čiji roditelji imaju registrovano i aktivno poslovanje biznisa, o čemu svedoči Centar za registraciju preduzeća.
3. Korisnik ove stipendije ne može biti student ako je u istoj fiskalnoj godini bio korisnik stipendije koju dodeljuje centralna vlada ili bilo koji drugi donator u oblasti obrazovanja.
4. Ako se utvrdi da student koji je korisnik stipendije od opštine dobija stipendiju od druge budžetske jedinice, dužan je da stipendiju vrati.
 - Potrebna dokumentacija za prijavu:
 - Obrazac prijave sačinjen od strane Direkcije za obrazovanje;
 - Potvrda da je student upisao/la akademsku godinu 2019/20 (original);
 - Svedočanstvo o članstvu (original);
 - Potvrda da student ne koristi drugu stipendiju;
 - potvrdu o stalnom prebivalištu;
 - Kopija lične karte;
 - Izvod iz rođenih;
 - Potvrda o korišćenju socijalnu pomoći u 2019/20;
 - Studenti upisani u školskoj / akademskoj godini 2019/20, overene kopije svedočanstva i diploma prethodne škole.

Rok za prijavu na konkursu je 15 (petnaest) dana od dana objavljivanja konkursa. Nepotpuni dokumenti neće biti razmatrani.

Prijave se podižu i kompletirane podnose u opštini Suva Reka, kancelarija br.1 Svakog radnog dana od 8:00h do 16:00h.

Direkcija za Obrazovanje

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë kandidatët se anulohet konkursi për arsye objektive për pozitën: Zyrtar i Shitjes (5) ekzekutues, Teknik (5) ekzekutues, i shpallur me datë 09.11.2019 me numër 01-6075/19.

I falënderojmë të gjithë aplikantët për shprehjen e interesimit për të qenë pjesë e TK Sh.A, dhe luteni që të shikoni web faqen e Telekomit të Kosovës Sh.A për konkurset publike në të ardhmen.

Prishtinë, 20.11.2019

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898
Sallon Depilimi Lumë's Details
lumesdetails
Mbrrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Donika Sanaja, shpall të pavlefshëm dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme "Xhevdet Doda" në Prishtinë.

► Erëza Salihu, e lindur më 01.01.1985 në Brodosanë, Komuna e Dragashit, shpall të pavlefshme Licencën e punës si doktor i mjekësisë me nr: KO-05438-01, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë.

► Restaurant "NEWCO IMB" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70504162.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

► Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shiheni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.

► Shesim banesën dy dhomshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 kati 3 ndërtim i vjetër, e rinovuar komplet, me nxemje të qytetit, çmimi 77 000€. Informatat tel:049/400-958 dhe 044/627-387

► Lëshoj banesën e pamobiluar (garsonierë) me qira. Banesa, e cila gjendet rrugës për në Gërmi, 150 metra afër Kolegjit Amerikan A.U.K, ndodhet në katin 5. Çmimi 130 euro. Tel: 049/705-503 dhe 049/662-211.

► Lëshoj garsonierën me qira 13 m2 kati i IV (katër) në Lagjen Ulpiana. Çmimi 150 euro. Për info: 044/637-546.

U bene 8 vite pa me te dashurin babën tonë

TAHIR KAJTAZI

(03.02.1932- 21.11.2019)

Fjalët janë te pakta për ta përshkruar humbjen dhe dhembjen tende që le pas vetes. S'ka fjale as vaj që e shuan mallin për ty, si dhe te mbetesh në zemrat tona, në të cilat u hap një plagë që nuk shërohet kurrë, se dashuria dhe prania e jote na mungon shume, se malli dhe lotët në sy të përkujtojnë pa u ndalur kurrë. Vepra dhe puna jote mbesin shembull për të gjithë ne.

E përkujtojnë me shume mall: Bashkëshortja Fatimja, vajza Myrvetja, dhëndëri Enveri, vëllai Ajeti dhe gjithë familja Kajtazi nga Ternova e Skenderajt.

